

Procesverbal

Nga Mbledhja III (e tretë) e rregullt për vitin 2026 e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë: 31.03.2026

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Miratimi i Planit të Punës së KKSBB-së për vitin 2026;
3. Propozim vendim për miratimin e Raportit të Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësit natyrore dhe fatëkeqësit tjera në Infrastrukturë Publike;
4. Propozim vendim për miratimin e Raportit të Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësit natyrore dhe fatëkeqësit tjera në Ekonomi Familjare;
5. Miratimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2025 dhe Plani i Punës për vitin 2026;
6. Eventuale.

Resul Fetahu: Të nderuar të pranishëm, mirë se erdhët në seancën e tretë të rregullt për vitin 2026! Besoj se materialin e keni pranuar të gjithë me kohë. Në rendin e ditës i kemi pesë pika, si dhe pikën eventuale. Nëse dikush dëshiron ta marrë fjalën lidhur me rendin e ditës, urdhëroni!

Usmen Baldzi: Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetarit të komunës, anëtarëve të kuvendit, kolegëve, të gjithë të pranishmëve, mediave, përfaqësuesve të OSBE-së dhe të gjithë atyre që ndjekin punën e kësaj seance. Para miratimit të rendit të ditës, dëshiroj të njoftoj kuvendin për një ngjarje të pakëndshme që përjetova dje në seancën e Komitetit për komunitete. Mendoj se është e rëndësishme që edhe kryetari të jetë i informuar për këtë, sepse të gjitha propozimet që kam paraqitur gjatë punës së komitetit, fatkeqësisht, nuk janë marrë as në votim, as në shqyrtim. Në vend të kësaj, nga ne u kërkua që rendi i ditës të miratohet pa diskutim, gjë që nuk është në përputhje me aktet dhe procedurat në fuqi të kësaj komune. Gjithashtu, dëshiroj të propozoj një ndryshim në lidhje me pikën 6 të rendit të ditës, e cila lidhet me miratimin e raportit të punës së pushtetit ekzekutiv. Bazuar në rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës të vitit 2010 (Rregullore nr. 02), shefi i Zyrës për komunitete ka detyrimin të paraqesë raporte vjetore, jo vetëm kryetarit dhe kuvendit, por edhe komiteteve kompetente. Në këtë drejtim, mendoj se pika 5, pra miratimi i raportit të punës së pushtetit ekzekutiv, nuk është e plotë dhe është e nevojshme të plotësohet në përputhje me rregulloren e përmendur, në mënyrë që raportimi të jetë plotësisht transparent dhe në përputhje me detyrimet ligjore. Propozoj kuvendit që këtë pikë ta shtyjë, ose, nëse e pranojmë, të lejojë mundësinë që në seancën e ardhshme të Kuvendit, Zyra e re për

komunitete të paraqesë raportin e plotë të punës për vitin 2005, duke pasur të drejtë të shqyrtojmë edhe raportin dyvjeçar që përfshin vitin 2004. Gjithashtu, kërkojmë nga shefi i Zyrës që të raportojë rregullisht Komitetit për komunitete, sepse kjo është detyrë e tij direkte.

Kjo janë dy gjëra. Kjo e para – të informoj dhe të kërkoj nga kryetari, që të jem i qartë, të paralajmëroj kryetaren e Komitetit për komunitete që të kërkohet ose edukimi nga organet dhe organizatat që merren me ofrimin e ndihmës në punën e kuvendeve në Kosovë, veçanërisht në nivel lokal, në mënyrë që t'i ndihmojnë në përmirësimin e punës. Gjithashtu, mendoj se është e nevojshme të edukojmë më tej – nuk ka asgjë të turpshme në këtë – ose që të respektohen në mënyrë rigoroze rregullat e punës së Kuvendit, Statuti i komunës dhe aktet e tjera në fuqi. Kjo është një gjë, dhe pika e dytë është propozimi im që të shtyhet, ose të merret vendim që të gjitha këto çështje të shqyrtohen në një kuvend të ardhshëm. Ky është propozimi im.

Resul Fetahu: Atëherë për kërkesën e z.Baldi që ka kërkuar për Zyrën e Komuniteteve, që raportin t'a bëjnë në një seancë tjetër se për këtë seancë nuk mundim me e shty për shkak të afateve ligjore. A do dikush tjetër me marr fjalën?

Artan Loshaj: Përsëritet për të gjithë! I nderuar kryesues, edhe dje në komitet kam kërkuar që ta kemi materialin në kopja fizike, sidomos që sot është një material voluminoz mbi 200 faqe dhe nuk kemi mundësi që ta shfletojmë dhe të dalim këtu të diskutojmë. Këtë e ka kërkuar edhe kolegija z.Xhyllferija që të rregullohet salla dhe të ketë kushte për seancë. Herën e parë ke heshtur por edhe dje nuk mora përgjigje. Kërkoj nga ju, por edhe nga kryetari që së paku të kemi kopje fizike ose që të kemi për seancën e ardhshme. E dyta, pasi që e kemi pikën e rendit të ditës për raportet, është mirë që secili drejtor të jetë prezent këtu, e sidomos ata të SDU-s, të na raportojnë për punën e vitit 2025 se çfarë kanë punuar dhe planin e punës për vitin 2026. Ju faleminderit.

Resul Fetahu: Faleminderit Artan! A do dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim rendin e ditës. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Me 16 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës. Vazhdojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 17 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Miratimi i Planit të Punës së KKS-së për vitin 2026. A dëshiron dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Përsëritet edhe një herë. Pasi që nuk e kam materialin, po duhet me e lexuar prej telefonit, e pashë aty në raport që kryetari kërkon bashkëpunim ndërkuftar, sidomos me

Shqipërinë: Shqyrtimi i mundësive për bashkëpunim ndërkufitar për projekte dhe vizita të përbashkëta. Është shumë mirë pasi që synoni me bë një bashkëpunim përmes projekteve. Propozojmë që të planifikohet hapja e rrugës për në Orqush-Orgjost, për arsye se kjo qeveri dhe qeveritë të tjera kanë hapur rrugë edhe për Pakishtë edhe për Borje. Është e vetmja rrugë që në pikë kufitare nuk ka rrugë. Është mirë që këtë vit me planifiku me hap këtë rrugë. Është mirë që vitin e tashëm me planifiku me hap rrugën, për arsye se shumë njerëz nga andej vinë këtu për shërim, për tregti dhe për gjëra të tjera. E dyta, e keni një plan për rregullimin e trotuareve. Është mirë kryetar, që edhe inspektorat e juaj dhe drejtoria të cilës i përkasin që këto trotualet këtu që janë pak të zënta është mirë pak me i liru, sepse çdo ditë kalojmë edhe ne, por edhe nxënësat e shkollës, trotuarët janë të bllokuara. Është mirë që këto trotuare të lirohen për qytetarët e jo për bizneset. Ju faliminderit!

Usmen Baldzi: Plani i punës së Komitetit për siguri është në rregull, plani është i pranueshëm. Ka shumë gjasa që të miratohet dhe meriton mbështetje, me ndryshimin që ka propozuar zoti. Jam dakord, veçanërisht është e rëndësishme çështja e fshatit Orgosta, i cili është më i madhi ndër këto fshatra afër kufirit, dhe banorët e tij vijnë në Dragash për trajtim, tregti dhe aktivitete të tjera. Dëshiroj të propozoj edhe një gjë tjetër, që lidhet me Komitetin për siguri në lidhje me Drejtorinë për Shëndetësi në komunën e Dragashit dhe me Zyrën për mbrojtjen e të drejtave të grave ose gjinisë. Ekzistojnë disa persona – pacientë, ose, le t'i quajmë, individë që duhet të përdorin rregullisht medikamente të caktuara për të ruajtur shëndetin e stabilizuar – doktori do të më kuptojë, kryetar. Do të ishte e mirë që ky komitet të caktojë një person, grup ose dikë nga Drejtoria për Shëndetësi që do të kujdeset dhe regjistrojë përdorimin e këtyre medikamenteve, në mënyrë që ata të jenë të siguruar shëndetësisht, dhe kjo lidhet me sigurinë e atyre që nuk janë të rrezikuar. Doktor, nuk ka nevojë për shumë shpjegime – bëhet fjalë për njerëz që, nëse nuk përdorin këto medikamente, mund të bëhen potencialisht të rrezikshëm për komunitetin, familjen, fqinjët dhe miqtë. OSBE-ja, sipas propozimit tim, duhet të formojë një task force – një grup prej disa personash nga Departamenti i Shëndetësisë, që do të kujdesen për këta persona në territorin e komunës. Ka shumë gjasa që e kuptoni se vitin e kaluar kemi pasur një situatë në Restelicë, që mund të jetë një nga shkaqet e këtyre problemeve. Pra, flasim për njerëz që, për shkak të gjendjes mendore dhe përdorimit të disa substancave, mund të shkaktojnë probleme të caktuara. Mendoj se ky propozim është i arsyeshëm dhe duhet të mbështetet. Faleminderit.

Resul Fetahu: Ju faleminderit! A do dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 17 vota për, zero kundër dhe 4 abstenime, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e tretë: Propozim vendim për miratimin e Raportit të Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësit natyrore dhe fatëkeqësit tjera në Infrastrukturë Publike; A do dikush tjetër me marrë fjalën?

Flurim Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë. Unë jam kryetari i komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësit natyrore. Ju informojë se për fat të keq se më 6 Janar të këtijë viti kemi pasur vërshime në Komunën tonë, ku janë shkaktuar dëme në një numër të konsiderueshëm në ekonomi familjare gjithashtu edhe në infrastrukturën e Komunës. Si komision kemi bërë angazhime maksimale dhe vlerësimet për çdo kërkesë që është bërë. Numri i kërkesave përgjegjshëm të cilat kanë arritur tek komisioni është 40, por në qoftë se i kategorizojmë, 28 janë për ekonomi familjare, 8 janë në infrastrukturë komunale, ndërsa 4 kërkesa të cilat janë bërë nuk ka pasur vlerësim sepse janë bërë pas vërshimeve të cilat kanë hyrë në procesin e vlerësimit. Komisioni sa i përket vlerësimit ka bashkëpunuar edhe me Agjencinë Nacionale të Vlerësimeve, sidomos te çmimet janë suportuar nga formularët që janë dhënë, kështu që numri i tyre është procesuar. Në materialet që janë dhënë, numri i ekonomive familjare është 28 të shqyrtuara që kanë hyrë në proces të vlerësimit dhe këto kapin një buxhet të përgjithshëm 168,00.400 euro. Ndërsa sa i përket infrastrukturës publike, vlera buxhetore e përgjithshme është 197,000.758 euro. Por në qoftë se shikojmë në buxhet të përgjithshëm, është 358,000.009 euro. Do të thotë të dy kategoritë, edhe në ekonomi familjare, por edhe në infrastrukturë publike. Dëmet në infrastrukturë kanë qenë sidomos në rrugët e vjetëra, kanë bërë dëme në rrëzimin e murave mbajtëse dhe rrugëve, edhe disa dëme të tjera. Ndërsa në ekonomitë familjare, dëmet kanë qenë të natyrave të ndryshme. Ka pasur vërshime të cilat për fat të keq, uji ju ka futur brenda, edhe ka shkaktuar dëmet të tjera materiale. Në pikat e shkurtëra, këto janë dëmet që janë bërë nga vërshimet. Pra, secila lëndë e ka dokumentacionin e vetë, konform legjislacionit në fuqi, edhe janë të gatshme dhe të disponueshme për çdokënd i cili është i interesuar. Ju faleminderit.

Usmen Baldzi: Kam konstatuar me kryetarin e komunës, kryetarin e komunës, aty ku nuk më ishte e qartë nëse, bazuar në kapitujt dhe hyrjen e këtij vendimi, dmth bazën ligjore, jemi në të drejtë kur si kuvend marrim një vendim të tillë. Çdo vendim i kuvendit zakonisht kërkon një buxhet të caktuar, por duke qenë se këtu nuk ka buxhet dhe bëhet fjalë për një çështje të fatëkeqësisë natyrore, kryetari më ka siguruar – dhe besoj se ka të drejtë – që kemi të drejtë si kuvend të marrim këtë

vendim. Gjithashtu, besoj se komisioni ka kryer vlerësimin e dëmit në mënyrë të drejtë dhe reale, por dje, gjatë bisedës me përfaqësuesin e fshatit Mlike, kuptova se komisioni ka vlerësuar dëmin vetëm aty ku ka ndodhur, dhe jo më gjerë në të gjithë zonën e prekur. Nuk është gabim, por mendoj se fshati Mlike duhet të vizitohet edhe një herë, sepse ekziston dëmi që ka ndodhur si pasojë – për shembull, disa rrugë, disa gurë të rrëzuar nga toka – dhe ka rrezik që të dëmtohen edhe më tej. Kam frikë se 75,000 euro ndoshta nuk do të jenë të mjaftueshme për të kompensuar dëmin. Propozimi im është që, para se vendimi të shkojë në Prishtinë, fshati Mlike të vizitohet edhe një herë dhe të kontrollohet nëse buxheti prej 75,000 eurosh mund të përmbushë pritshmëritë, dmth nëse do të mjaftojë për të mbuluar dëmin real.

Artan Loshaj: Nga kryetari i komisionit morrëm një shpjegim, por unë deshta me pyetë kryetarin, por edhe kryetarin e komisionit, kush e bën këtë kompenzimin e këtyre dhe ku ka mbetur gjendja e vërshimeve të vitit të kaluar. Ata qytetar ende presin përgjigje nga kryetari i Komunës dhe Qeveria. A do të kompensohen ata? Dhe me këtë komision tash kush do të merret me kompensimin e këtyre? A do të merret Komuna apo Qeveria? Se ata qytetar tashmë një vit e gjysmë presin. Më duhet një përgjigje prej kryetarit, qoftë prej kryetarit të komisionit. Më intereson se ku ka mbetur puna me ata të parët të cilët kanë aplikuar dhe çka do të ndodhë me këta të tjerët. Ju faleminderit.

Bexhet Xheladini: Të nderuar të pranishëm! Sa i përket, kësaj pike të rendit të ditës, Siç e dini, kryetari i Komunës, në bazë të ligjit të vetëqeverisjes lokale dhe në bazë të statutit të Komunës dhe në bazë të ligjit 04L027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, unë si kryetar i komunës kam themeluar komisionin komunal për vlerësimin e dëmeve, i cili pas përfundimit të shpalljes, unë si kryetar i Komunës kam njoftuar të gjithë qytetarët e Komunës dhe personat të cilët kanë pësuar dëme nga vërshimet e fundit të paraqesin kërkesat e tyre në zyrën e pranimi. Pasi ka përfunduar këu afati i aplikimit komisioni komunal ka dalur në vend të ngjarjes dhe i ka vizituar të gjitha shtëpit dhe ekonomitë familjare, dhe me atë rast kanë hartuar raport për dëmet e shkaktuara. Gjithashtu, përveç dëmeve që kemi pasur në ekonomitë familjare, ka pasur edhe dëme në infrastrukturë publike. Dhe ato dëme shumica kanë qenë nga rrëshqitja e dheut dhe u dëmtua kryesisht infrastruktura rrugore. Dëmet më të mëdha janë në infrastrukturë të cilat kanë qenë në fshatin Mlikë, kurse dëmet tjera kanë qenë si pasojë e rrëshqitjes së dheut dhe rrëshqitjes së murave mbrojtëse. Komisioni komunal, edhe në këto raste ku është dëmtuar prona publike, ka përgatitur paramasat dhe parallogaritë për projektet të cilat për çdo rast i keni t'paraqitura ju në raport për të cilat janë zotuar kësaj rradhe se dëmet e shkaktuara nga vërshimet e fundit do t'i

paguajnë. Ndërsa sa i përket pyetjes së delegatit se çfarë kanë ndodhur me kompensimin e dëmeve që janë bërë nga vërshimet e vitit të kaluar, sot e kësaj dite qeveria për ato nuk ka bërë asnjë lloj kompensimi të atyre dëmeve. As në infrastrukturë publike, por as edhe në ekonominë familiare. Kështu që edhe për kundrejt kërkesës të cilën e kemi dërguar në Qeveri dhe në Ministrinë e Kosovës, dhe kërkesave të mia të vazhdueshme që për me bo ata pagesën, sot e kësaj dite ky kompensim për qytetarët nuk është bërë. Por kjo nuk do të thotë se ne do ta heqim dorë nga kërkesa jonë që edhe dëmet e shkaktuara para një viti e gjysmë të paguhen, ju faleminderit.

Granit Rifaj: Përshëndetje për të gjithë! Desha ta ndërlidhëm me pikën 3 dhe 4 të rendit të ditës lidhur me fatkeqësitë natyrore të cilat kanë ndodhur në ekonomi dhe infrastrukturë. Për këtë punë e diim se komisioni i bën vlerësimet dhe i dërgon në qeveri dhe ministri dhe ata vendosin për këtë punë. Por duke e ditur praktikën që deri sot nuk është kompensuar askush, a kemi të pakten një mundësi që ne ta bëjmë diçka të këtyre ekonomive familjare si komun me i kompensu. Në qoftë se jo, atëherë e votojmë dhe i dërgojmë në qeveri. S'kemi çka bëjmë më tepër debat për këtë. Ju faleminderit.

Resul Fetahu: A do dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë, e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 18 vota për, zero kundër dhe 0 abstenime, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e katërt: Propozim vendim për miratimin e Raportit të Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësit natyrore dhe fatëkeqësit tjera në Ekonomi Familjare. A do dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë, e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 17 vota për, zero kundër dhe 0 abstenime, miratohet edhe kjo pikë.

Vazhdojmë me pikën e pestë: Miratimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2025 dhe Plani i Punës për vitin 2026. A do dikush tjetër me marrë fjalën?

Usmen Baldzi: Ne kemi miratuar tashmë rendin e ditës. Kjo është vetëm një ndërhyrje për të lehtësuar situatën, duke pasur parasysh që pika e rendit të ditës është e gjërë dhe kam dëgjuar që disa anëtarë nuk kanë kopje të materialeve në version të shtypur. Gjithashtu, duke pasur parasysh që sot kemi një ditë të bukur dhe një ndeshje mes përfaqësueses së Kosovës dhe Turqisë, mund të relaksohemi pak. Për të ndihmuar edhe drejtorët e rinj – mendimi dhe propozimi im është që drejtorët e sapoemëruar të mos prezantojnë raportet e punës, sepse ata nuk kanë qenë në ato pozicione vitin e kaluar. Planet mund të prezantohen, por jo raportet. Drejtorët e vjetër, dmth ata të rizgjedhur, logjikisht mund të prezantojnë raportet e tyre. Në këtë mënyrë do të ulim ngarkesën,

dhe gjithashtu dua të falënderoj kryetarin, sepse ai ishte i vetmi nga raportuesit që solli diçka të re në raportin e tij. Dhe shohim pak ndryshime edhe në Drejtorinë për Administratë, sepse ju e dini që kam qenë kryetar partie dhe kam pasur më parë mundësinë të lexoj dhe ndjek raportet e kuvendeve të mëparshme. Duhet t'ju them se shumica e këtyre raporteve janë kopje – kjo është e vërtetë, por nuk dua të hyj më tej tani, kjo është një temë tjetër. Nëse pranoi propozimin tim, është mirë – do të lehtësojmë për të gjithë, edhe për ne në kuvend, pa marrë parasysh pozicionin ose opozitën, por edhe për drejtorët. Nuk është logjike që një drejtor i sapoemëruar të paraqesë raportin për atë që ka punuar më parë në atë funksion, sepse kjo thjesht nuk është reale.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, pika e pestë rendit të ditës është një prej pikave më të rëndësishme vjetore, e cila paraqet një pasqyrë të punës së kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit për vitin 2025. Raportin e detajuar i cili është mbi 100 e diçka faqe e keni pranuar në mënyrë elektronike, të gjithë. Për ata të cilët nuk kanë laptop dhe janë asamblistë të ri, atyre j'au kemi dërguar planin dhe raportin e punës në formë fizike. Kështu që kërkesën të cilën e bëjnë që materiali të dërgohet në formë fizike, unë besoj që është jo e arsyeshme. Mandatin e kaluar, kemi vendosur që të gjithë asambleistat t'i pajisim me laptop në mënyrë që t'ua dërgojmë materialin të gjithëve në formë elektronike dhe në këtë mënyrë ne do të kursejmë edhe në letër por edhe në punë, por edhe do të kursejmë edhe në shpenzimin e tonerave, po ashtu do të kursejmë edhe në punën e zyrtarëve komunalë. Gjithashtu do të ketë edhe kurseime të tjera sa i përket printerave. Kështu që derisa delegatët e rinj të pajisen me laptopa, ne do t'ua dërgojmë atyre në formë fizike. Në fillim dua të paraqes një përmbledhje të shkurtër të kryetarit të Komunës edhe të qeverisë komunale për vitin 2025 edhe planin e punës për vitin 2026. Pastaj, sipas nevojës, drejtorët komunal me kërkesën tuaj mund të dalin secili që të raportojnë. Pra do të jenë të gjithë drejtorët të obliguar që t'iu përgjigjen pyetjeve tuaja eventuale. Kështu që unë po filloj me leximin e përmbledhjes së shkurtër të punës së kryetarit të komunës dhe ekzekutivit.

Qytetarë të Komunës së Dragashit,

Bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Dragashit 01nr.06-103/1 i datës 11.09.2008, kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes raportin vjetor janar – dhjetor 2025 për te arriturat, sukseset, angazhimet por edhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat është përballur Komuna e Dragashit gjatë vitit 2025.

Si rezultat i punës së përbashkët dhe bashkëpunimit të mire brenda dhe jashtë institucionit, kemi arritur që të kryejmë pjesën më të madhe të objektivave, aktiviteteve si dhe detyrave sipas planifikimeve strategjike dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Që të jetë sa ma transparent për publikun, Komuna e Dragashit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t’iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin dhe vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Puna e Kryetarit, përkatësisht ekzekutivit të Komunës së Dragashit, është zhvilluar përmes 8 drejtorive dhe shërbimeve përcjellëse të Komunës, në harmoni me legjislacionin, udhëzimet dhe Statutin e Komunës.

(GJASHTËMUJORI I PARË)

- Edhe përgjatë këtij viti, kemi vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me institucionet dhe përfaqësitë diplomatike ndërkombëtare. Kemi pritur për një vizitë me rëndësi ambasadorin e Britanisë së Madhe, Jonathan Hargreaves;
- Gjithashtu, kemi pritur edhe ambasadorin e Republikës së Turqisë, Sabri Tunç Angili;
- Kemi pasur takim edhe me komandantin e KFOR-it nga Komanda Rajonale Perëndim, Kolonel Francesco Errico, me të cilin kemi diskutuar lidhur me situatën e sigurisë dhe çështje që prekin interesin e përgjithshëm të qytetarëve;
- Kemi zhvilluar takime dhe kemi formalizuar Marrëveshjen me Projektin HELVETAS/DEMOS, për bashkëpunimin dhe konsultimin lidhur me organizimin e takimeve buxhetore dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje;
- Nën organizimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Institutit për Planifikim Hapësinor, kemi marrë pjesë në takimin publik lidhur me shqyrtimin e Draftplanit Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri dhe Draftraportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Hapësinor në Parkun Kombëtar Sharr, ku kemi paraqitur kërkesat tona dhe të qytetarëve, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e mundësive për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe turistik të Komunës sonë;

- Në fushën e përfaqësimit gjinor në institucionet publike, këtë vit kemi shënuar edhe një hap tutje, ku kemi emëruar edhe dy gra në pozita udhëheqëse: zëvendës drejtoreshën e QKMF-së, e cila për më tepër është edhe nga komuniteti joshumicë, si dhe drejtoreshën e Çerdhes në Dragash;
- Në bashkëpunim me partnerët tanë, kemi filluar edhe realizimin e Porjektit të Papa Testit pa pagesë për të gjitha gratë e Komunës sonë, një iniciativë kjo e Grupit të Grave Asambleiste. Ky përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore;
- Në këtë drejtim, gjithashtu kemi filluar edhe programin e vizitave sistematike shëndetësore nëpër shkollat e Komunës së Dragashit, për nxënësit e klasave të para dhe të pesta, një program i realizuar me sukses nga profesionistët tanë shëndetësorë;
- Në kuadër të vizitës studimore të realizuar nga Asambleja Komunale, si kryetar i Komunës, së bashku me Kryesuesen e Kuvendit kam realizuar një takim me kryetarin e Komunës Purkersdorf të Austrisë, me të cilin jemi dakorduar që të thellojmë bashkëpunimin ndërmjet komunave tona, me theks të veçantë në binjakëzimin ndërmjet komunave;
- Për këtë qëllim, ne kemi kaluar procedurat fillestare në Kuvendin e Komunës, ku delegatët me shumicë votash kanë votuar për nisjen e procedurave të binjakëzimit;
- Gjithashtu, Komuna e Dragashit tashmë edhe zyrtarisht është binjakëzuar edhe me Komunën e Mavrovë-Rostushës nga Maqedonia e Veriut, gjatë ceremonisë e cila u zhvillua me rastin e Ditës së Çlirimit të Dragashit;
- Me partnerët nga HELVETAS/DEMOS kemi finalizuar nënshkrimin e Marrëveshjes për Mbështetje Financiare të projektit "Asfaltimi i rrugëve dhe kubëzimi i rrugëve në regjionin e Gorës në Dragash (fshatrat Restelicë dhe Radeshë)", nga Skema e Grantit për Performancë Komunale;
- Kemi pasur edhe një vizitë me rëndësi nga Përfaqësuesja Speciale e Sekretariatit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, znj. Caroline Ziadeh, ku kemi diskutuar për bashkëpunim e ndërsjellë dhe mbështetjen e ofruar nga UNMIK-u, veçanërisht në zbatimin e projekteve, siç janë Papa Testi dhe përmirësimi i shërbimeve dentare në QKMF, me theks të veçantë për personat me nevoja të veçanta;
- Kemi nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Kryerjen e Shërbimeve Postare ndërmjet Komunës së Dragashit, Policisë së Kosovës dhe Postës së Kosovës;
- Gjithashtu, kemi pasur nderin që t'i presim në një takim miqësor përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta, me të cilët kemi pasur një bashkëbisedim të frytshëm rreth ecurisë

së bashkëpunimit dhe mbështetjes që Komuna jonë në vazhdimësi ka ofruar për OVL-në e UÇK-së në Dragash;

- Kemi pasur takime edhe me përfaqësues të fshatrave dhe institucioneve shëndetësore nga fshatrat kufitarë të Shqipërisë, si Zapodi, Pakishta etj., me të cilët kemi diskutuar lidhur me shërbimet shëndetësore falas dhe trajtimin e barabartë që Komuna E Dragashit ua bën qytetarëve nga Shqipëria;
- Së bashku me kryesuesen e Kuvendit, kemi zhvilluar një vizitë tek humanisti Halil Kastrati, ku kemi folur rreth mundësisë së thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Dragashit dhe shoqatës "Jetimat e Ballkanit" të cilën e drejton humanisti Halil Kastrati. Ky bashkëpunim do të fokusohet në mbështetjen e ofruar për qytetarët e Komunës sonë, me theks të veçantë në ndërtimin e shtëpive të banimit për njerëzit në nevojë, ku shoqata "Jetimat e Ballkanit" dhe Komuna e Dragashit do të jenë bashkëfinancuese;
- Me Ministrinë e Zhvillimi Rajonal kemi vazhduar bashkëpunimin, ku gjatë këtij muaji kemi pritur në takim ministrin e MZHR-së, z.Fikrim Damka, me të cilin kemi diskutuar lidhur me thellimin e bashkëpunimit, konkretisht në mbështetjen financiare që MZHR-ja do të na ofrojë në realizimin e disa projekteve kapitale;
- Në fillim të këtij viti kemi marrë edhe një vendim të rëndësishëm: Komuna e Dragashit ka marrë përsipër pagesën e shpenzimeve të ndriçimit publik për të gjitha fshatrat të cilat e kanë të instaluar ndriçimin;
- Gjithashtu, kemi bërë edhe përrurimin e rrjetit të ndriçimit publik në fshatrat Brrut dhe Pllavë;
- Si qeverisje lokale, kemi marrë pjesë në të gjitha manifestimet për ditët e shkollave në të gjitha shkollat fillore dhe në Shkollën e Mesme “Ruzhdi Berisha”.

(GJASHTËMUJORI I DYTË)

- Bashkë me organizatën partnere IOM dhe me financimin e BE-së, kemi bërë hapjen e Kabinetit të ri të Infermierisë në Gjimnazin “Ruzhdi Berisha”, një mundësi e mirë për të ngritur cilësinë e mësimdhënies dhe për të lehtësuar mësimnxënien praktike të nxënësve;
- Së bashku me përfaqësues të Qeverisë Lokale, kemi zhvilluar një vizitë zyrtare në Bashkinë e Lezhës në Republikën e Shqipërisë, ku kemi shqyrtuar shkëmbimin e eksperiencave dhe mundësitë e bashkëpunimit mes dy institucioneve tona;

- Me Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren kemi nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me qëllim të mbështetjes së organizimit të Shkollës Verore Ndërkombëtare 2025;
- Në muajin korrik kemi filluar njërin nga projektet më të rëndësishme të Komunës sonë për stabilizimin e furnizimit me energji elektrike: ndërtimin e rrjetit TM 10(20) kV dhe TU 04 kV në segmentin Globoqicë-Krushevë-Restelicë, si dhe rrjetit TM 10(20) kV dhe TU 04 kV në drejtim të fshatit Brod. Vlera e përgjithshme e projektit është rreth 800,000 euro, ku 45% e mjeteve janë siguruar nga komuna, ndërsa pjesa tjetër prej 55% është financuar nga KEDS;
- Gjithashtu, në fshatin Restelicë kemi bërë hapjen e objektit për depozitimin e mbeturinave, i cili është financuar nga Qeveria Japoneze përmes Programit GGP (Grante për Projekte për Sigurinë Bazike Njerëzore);
- Në fshatin Krushevë kemi hapur objektin e ri të Qendrës së Mjekësisë Familjare, duke sjellur shërbimet jetike shëndetësore më afër qytetarëve, veçanërisht për komunitetin joshumicë që jetojnë në këtë pjesë të Komunës së Dragashit. Ndërtimi i kësaj qendre moderne është financuar nga buxheti vetanak i Komunës së Dragashit, ndërsa aparatura dhe pajisjet janë siguruar falë bashkëpunimit të shkëlqyer me Agjencinë Turke për Zhvillim dhe Bashkëpunim (TIKA);
- Kemi bërë lansimin e programit për Rrobaqepësi, një iniciativë që synon fuqizimin e grave dhe vajzave të Komunës sonë, përmes aftësisimit profesional dhe krijimit të mundësive të reja për punësim. Ky projekt implementohet ngë OJQ “AVOKO” dhe është financuar nga Kryesia e Këshillit Turk në Kosovë, përmes Njesisë së CIMIC-ut dhe me mbështetjen e LMT-së në Dragash;
- Në bashkëpunim me “Ekoregjionin”, kemi përfshirë në sistem dhe kemi filluar grumbullimin e mbeturinave nga të gjitha fshatrat e Komunës së Dragashit;
- Në Kuadër Të Projektit qeveritar “Banimi Social Adekuat”, kemi hapur Thirrjen publike për Renovimin/Rindërtimin e Shtëpive Private Për Familjet e Cenueshme;
- Në bashkëpunim dhe me mbështetjen e LMT-së së KFOR-it Turk në Dragash, kemi bërë hapjen dhe trasimin e rrugës Rrenc-Xërxe;
- Gjithashtu, kemi bërë edhe demolimin e objektit të vjetër të shkollës në fshatin Bellobrad;
- Me OJQ-të BIRN dhe AVOKO kemi nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit për zbatimin e Programit të Auditimit Social të katër projekteve të financuara nga Granti i Performancës;
- Nga muaji gusht i këtij viti, Komuna e Dragashit ka filluar mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për pompat e ujit në të gjitha fshatrat që furnizohen me ujë të pijshëm përmes

tyre, një hap ky i rëndësishëm për lehtësimin e barrës financiare të shpenzimeve mujore për qytetarët tanë;

- Nga CIMIC-u italian i KFOR-it kemi pranuar një kontigjent të mjeteve teknike për Shërbimin e Zjarrfikësve në Komunën tonë, të cilat do të kontribuojnë në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve që ofron kjo Njësi;
- Me Agjencinë Kadastrale të Kosovës kemi vazhduar bashkëpunimin për Projektin për Rindërtimin e Kadastrit, një iniciativë kjo e një rëndësie të veçantë për zgjidhjen e çështjeve pronësore të trashëguara ndër dekada për Zonat Kadastrale: Dragash, Leshtan, Bresanë dhe Pllajnik;
- Në nderim të jetës dhe veprës së veprimtarit Samidin Muhametit – Babait, sheshin te Pazari i Vjetër në fshatin Bresanë e kemi emërtuar: Sheshi “Samidin Muhameti – Babai”;
- Me rastin e Ditës Botërore të Pastrimit, edhe në Komunën e Dragashit kemi zhvilluar aktivitete të pastrimit të hapësirave publike, në bashkëpunim me organizatën "Let's Do It - Ta Pastrojmë Kosovën", duke realizuar kështu një fushatë të suksesshme për ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë që ka një mjedis i pastër në shëndetin publik;
- Në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, kemi organizuar aktivitetin tradicional sportiv “Vrapimi i Gjeneratës së Pavarësisë së Kosovës (2008)”, i cili u mbajt në Stadiumin e Qytetit në Dragash;
- Në shtator të këtij viti kemi organizuar edicionin e 4-të me radhë të Panairit me Produkte Vendore Lokale "EXPO SHARRI". Edhe ky edicion i kësaj ngjarjeje tashmë tradicionale ekonomike mblodhi së bashku prodhuesit lokalë, afaristët, institucionet dhe qytetarët, duke u shndërruar në një platformë të rëndësishme për promovimin e produkteve vendore dhe fuqizimin e zhvillimit ekonomik të komunës sonë;
- Në oborrin e QKMF-së në Dragash kemi hapur qendrën e hapur të fitnesit, një projekt ky i financuar nga Ambasada e Bullgarisë dhe implementuar nga Komuna e Dragashit dhe OJQ UBUGK. Kjo qendër do të shërbejë si një hapësirë sportive dhe rekreative për qytetarët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Komunën tonë;
- Po ashtu, në muajin tetor të këtij viti kemi bërë përrurimin e Çerdhes së fëmijëve në Dragash, pas një pune dhe angazhimi të palodhshëm. Ky institucion i rëndësishëm do t'u mundësojë fëmijëve tanë edukim dhe kujdes cilësor që në hapat e parë të jetës, ndërsa prindërve do t'ua lehtësojë përditshmërinë;

- Përmes Zyrës për Barazi Gjinore dhe në bashkëpunim me FSK-në, në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Vajzave kemi organizuar aktivitete me qëllim vetëdijesimin për rolin e vajzave dhe grave në shoqëri, si dhe promovimin e mundësive për karrierë në Forcën e Sigurisë së Kosovës;
- Në kuadër të aktiviteteve për Muajin Rozë, janë organizuar ligjërata vetëdijesuese lidhur me zbulimin dhe parandalimin e hershëm të kancerit të gjirit;
- Me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri", kemi nënshkruar Memorandumin për bashkëpunim në monitorimin dhe menaxhimin e pyllëzimeve dhe infrastrukturës përcjellëse në Zonën Kadastrale Restelicë, zonën e pyllëuar me mbështetjen e organizatës japoneze JICA;
- Në shtator të këtij viti kemi përfunduar njërin nga projektet më të mëdha kapitale në historikun e Komunës sonë: Ujësjiellësin për 15 fshatra dhe qytezën e Dragashit, duke shënuar kështu një hap të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të mirëqenies për qytetarët tanë;
- Edhe këtë vit kemi vazhduar ndarjen e bursave për studentët dhe studentet e Komunës sonë. Nga ky program kanë përfituar gjithsej 110 studentë, me një shumë totale prej 50 mijë eurosh (454.54€ për student);
- Gjatë vitit 2025, nga subvencionet në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë përfituar gjithsej 20 OJQ, me një shumë totale prej 147 mijë euro;
- Sa u përket investimeve kapitale, gjatë vitit 2025 kemi nënshkruar 106 kontrata për projekte të ndryshme, me një vlerë totale 4,483.115 €;
- Kemi marrë gjithsej 318 vendime për ndarjet të mjeteve për shërim, ku kanë përfituar 153 gra dhe 165 burra;
- Nga subvencionet për Bujqësi gjatë vitit 2025 kanë përfituar gjithsej 248 fermerë me një shumë totale prej 87,148 €.

Investimet Kapitale

Sa u përket investimeve kapitale, Komuna e Dragashit përgjatë vitit 2025 e ka realizuar në masë të konsiderueshme Planin e Prokurimit. Kemi nënshkruar mbi 100 (106) kontrata për realizimin e projekteve të ndryshme nëpër të gjithë territorin e Komunës sonë, të cilat lidhen kryesisht me modernizimin e infrastrukturës publike nëpër institucione shëndetësore dhe arsimore, kubëzimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale, ndërtimin e infrastrukturës sportive etj. Vlen të përmendet se gjatë

vitit 2025 ka përfunduar edhe njëri nga projektet më të mëdha kapitale: Ujësjellësi për 15 fshatra dhe qytezën e Dragashit.

- Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Mlik;
- Kubëzimi i rrugëve në rrugët e Pirkuçëve, kroi i diçë dhe Hani në Llapushnik në fshatin Brezne -Punime shtesë;
- Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i kanalizimit në rrugën Jarilice në fshatin Zlipotok;
- Kubëzimi i rrugëve dhe infrastruktura përcjellëse në fshatin Shajne - Projekt dyvjeçar;
- Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës - Grandi i performancës;
- Kubëzimi i rrugëve të Brrutit të vogël nga varrezat deri në fushë në fshatin Brrut – Ritenderim;
- Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i ujësjellësit në rrugën Kajqovce në fshatin Libevishtë – Ritenderim;
- Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Zaplluxhe - Projekt dyvjeçar – Ritenderim;
- Kubëzimi i rrugëve, ndërtimi i trotuareve si dhe rregullimi i përroit në fshatin Vraniq;
- Kubëzimi i rrugës në rrugën Ulica në fshatin Zgatar;
- Kubëzimi i rrugëve në fshatin Pllajnik - Projekt dyvjeçar;
- Hapja dhe kubëzimi i rrugës prekoreka në fshatin Krushevë - Projekt dyvjeçar;
- Kubëzimi i rrugëve Gorni Most, Visok Zavor, Ravnishte mahalla dhe sanimi i kanalizimit Tyrbe dhe podselo në fshatin Restelicë - Projekt dyvjeçar;
- Lot 1 - Kubëzimi i rrugëve Bresanë - Punime shtesë;
- Hapja, trasimi dhe kubëzimi i rrugës Kuk-Kosavë - Projekt dyvjeçar;
- Kubëzimi i rrugës Samedin Emini dhe Shelqja e Drugës në fshatin Kuk-Punime shtesë;
- Kubëzimi i rrugëve të Xhamija, ndërtimi i murit mbrojtës Qollopek dhe kanalizimi rruga Lugu I Pulës në fshatin Zym - Projekt trevjeçar;
- Kubëzimi i rrugëve Peto Mahalla, Shokovci Lika dhe rregullimi i përronit rruga Xhonjet në fshatin Brod - Faza 2;
- Kubëzimi i rrugëve Adem Berisha, Beteja e Buqes dhe Qerza në fshatin Buqe;
- Kubëzimi i rrugëve në fshatin Pllavë - Projekt dyvjeçar.

- Asfaltimi i rrugëve dhe ndërtimi i parkingut në rrugën Libevisht -Leshtan në fshatin Leshtan;
- Asfaltimi i rrugëve dhe kubëzimi i rrugëve në regjionin e Gorës në Dragash - (Fshatrat Restelicë, Radeshë) Granti i performancës – DEMOS – Ritenderim.
- Ndërtimi i murit mbrojtës dhe kubëzimi i rrugëve në fshatin Gllloboqicë;
- Ndërtimi i murit rreth lumit në fshatin Kuk - Projekt dyvjeçar;
- Ndërtimi i murit mbrojtës te Xhamia në fshatin Brezne.
- Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Gllloboqicë;
- Ndriçimi publik në qendër të fshatit Brrut;
- Ndriçimi publik në qendër të fshatit Kuklibeg - Projekt dyvjeçar;
- Ndriçimi publik në qendër të fshatit Pllavë - Projekt dyvjeçar;
- Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Rrenc - Punime shitesë;
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik në territorin e Komunës së Dragashit - Projekt trevjeçar;
- Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Gllloboqicë - Faza 2.
- Ndërtimi i impiantit për ujërat e zeza në rrugën e mullinit në fshatin Brezne;
- Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në qendër të fshatit Kapre - Projekt dyvjeçar;
- Rehabilitimi i ujësjellësve, kanalizimeve dhe pusetave në tërë territorin e Komunës së Dragashit - Projekt 36 muaj;
- Ndërtimi i kanalizimit dhe kubëzimi në rrugën Brezne-Likeni në fshatin Brezne - Projekt dyvjeçar;
- Renovimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Rapçë.
- Ndërtimi i trotuareve Brodosanë-Zaplluxhe si dhe Brrut-Bellobrad - (Granti I Performancës);
- Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne, ndërtimi i trotuarit Dragash - fshati Kukajan - (Granti I Performancës).
- Rehabilitimi i ngrohjes në shkollën “Ulina” Kosavë;
- Ndërtimi i këndit të lojërave, kubëzimi, demolimi i shkollës së vjetër në fshatin Bresanë;
- Renovimi (Adaptimi) i kabinetit të Mjekësisë në SHML “Ruzhdi Berisha” – Dragash;
- Ndërtimi i nyjeve sanitare dhe hapësirës multifunksionale në SHML “Ruzhdi Berisha” – Dragash - Projekt dyvjeçar;
- Renovimi i QMF-së dhe AMF-ve në fshatrat e Gorës - Projekt trevjeçar;

- Renovimi I koridoreve dhe shkallëve në objektin e QKMF-së dhe lysterja e objektit të Hendikosit.
- Ndërtimi i stadiumit në fshatin Restelicë - Projekt dyvjeçar;
- Ndërtimi i stadiumit në fshatin Blaç - Projekt trevjeçar;
- Ndërtimi i stadiumit në fshatin Pllavë - Projekt dyvjeçar;
- Ndërtimi i terreneve sportive Libevishtë - Projekt dyvjeçar;
- Mirëmbajtja dhe riparimi i zhveshtores në stadiumin e Dragashit.

Subvencionet për projekte kulturore, rinore dhe sportive

Gjatë vitit 2025, Komuna e Dragashit ka mbështetur financiarisht OJQ të ndryshme për organizimin e aktiviteteve të shumta në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Shuma e përgjithshme e mbështetjes financiare për këto projekte ka qenë 147 mijë euro.

PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

Gjatë periudhës raportuese për vitin 2025, Komuna e Dragashit ka zhvilluar aktivitete të rregullta të konsultimeve publike, përfshirë takime publike dhe dëgjime buxhetore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Në total janë realizuar dy takimet e rregullta publike me qytetarë brenda dy gjashtëmuajorëve. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 janë realizuar edhe gjashtë dëgjime buxhetore, tri prej të cilave për Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe tri për Draftin e Buxhetit të vitit pasues 2026. Në këto dërgjime Komuna e Dragashit ka synuar pjesëmarrjen sa më të gjerë të qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe grupeve të ndryshme të interesit, me qëllim të përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse dhe planifikuese të Komunës.

Lloji i konsultimit	Nr. total i pjesëmarrësve	Gra	Burra
TAKIMET PUBLIKE	75	18	57
DËGJIMET BUXHETORE	82	14	68
Totali:	157	32	125

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Transparenca dhe llogaridhënia mbeten ndër shtyllat kryesore të qeverisjes së mirë lokale. Në këtë kuadër, Komuna ka trajtuar me prioritet të veçantë zbatimin e legjislacionit në fuqi për qasje

në dokumente publike, duke garantuar të drejtën e çdo qytetari për informim të plotë, të saktë dhe në kohë.

Gjatë vitit raportues, administrata komunale ka siguruar trajtimin efikas të kërkesave për qasje në dokumente publike, në përputhje me afatet ligjore dhe standardet e transparencës institucionale. Përmes bashkëpunimit ndërmjet drejtorive komunale dhe Zyrës për Informim, është mundësuar shqyrtimi profesional i çdo kërkesë, duke respektuar njëkohësisht parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.

Numri i kërkesave të pranuara			
Numri total i kërkesave gjatë vitit 2025	Kërkesat e aprovuara plotësisht	Kërkesat e aprovuara pjesërisht	Kërkesat e refuzuara
6	6	0	0

SEKTORI LIGJOR

Zyra Ligjore, në kuadër të ushtrimit të përgjegjësiave dhe autorizimeve të saj, si dhe në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, për periudhën **janar – dhjetor 2025**, është angazhuar në ofrimin e ndihmës juridike, shërbimeve dhe këshillimeve ligjore, si dhe në harmonizimin, plotësimin, ndryshimin dhe hartimin e akteve nënligjore të propozuara nga Kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës dhe Drejtoritë Komunale në Komunën e Dragashit.

Për periudhën **janar – dhjetor 2025**, në këtë sektor është bërë:

- Udhëheqja e procedurave administrative sipas lëndëve përkatëse;
- Ofrimi i këshillave dhe opinioneve ligjore për Kryetarin e Komunës, Kuvendin e Komunës, Drejtoritë Komunale, sektorët dhe njësitë organizative;
- Hartimi dhe harmonizimi i rregulloreve dhe akteve juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë vendime, urdhëresa, marrëveshje dhe shkresa përcjellëse për Kryetarin, Kuvendin dhe Drejtorët e Drejtorive;
- Pjesëmarrja në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështje të caktuara;
- Pjesëmarrja në të gjitha seancat e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës;
- Kryerja e veprimeve në mënyrë të vazhdueshme dhe permanente;

- Arkivimi dhe sistemimi i dokumenteve të Zyrës Ligjore, si dhe përcjellja e vazhdueshme e ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve të nxjerra nga institucionet qendrore;
- Realizimi i objektivave të planifikuara për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2025.

OBJEKTIVAT E ARRITURA

Zyra Ligjore gjatë vitit 2025 ka dhënë kontribut të rëndësishëm në fushën e këshillimit dhe dhënies së opinioneve ligjore për të gjitha nevojat e administratës komunale, duke përfshirë edhe Kuvendin e Komunës.

Në vijim paraqiten aktet e hartuara nga Sektori Ligjor:

Nr.	Përshkrimi i lëndëve	Numri i lëndëve
1	Vendime për mjete për shërim	318 (165 gra, 153 burra)
2	Vendime për mjete për shërim me kancer gjiri	46 (45 femra , 1 mashkull)
3	Vendime për mjete për shërim fëmijë	20 (8 vajza, 12 djem)
4	Vendime për mjete për dializë	14 (4 femra, 10 meshkuj)
5	Vendim për pagesën e qirasë për 2 muaj sipas rekomandimit të QPS-së.	1
6	Vendim për ndihmë momentale për rastin tragjik të familjes F.I.	1
7	Vendime për botim të librit	3
8	Vendime për mjete për OJQ	4
9	Vendim për mjete për familjet e dëshmorëve	3 (3 anëtar)
10	Vendim për mjete për persona me nevoja të veçanta	2 (7 anëtar)
11	Vendim për mjete për stërvitje në K.F. Barça kamp	2
Total nr. i vendimeve		414

Nr.	Mjetet e lejuara nga pozicionet tjera	Numri i lëndëve
1	Vendim për mjete për maturantët	1
2	Vendim për udhëtime zyrtare	22
3	Vendime për dreka zyrtare	37
4	Vendim për pagesën e energjisë elektrike për ndriçim publik	12
5	Vendim për sigurimin e mjeteve për kartela për mbushje telefonike	11
6	Vendim për lejimin e mjeteve për Informim	17
7	Vendim për lejimin e mjeteve derivate	8
8	Vendim për lejimin e mjeteve – Vizitë studimore për asambleistët	1
9	Vendim për lejimin e mjeteve – Vizitë studimore për administratën	1

10	Vendim për pagesën e bursës për student	1 (104 përfitues)
11	Vendime të ndryshme	191
	Totali i vendimeve	302

Nr.	Lëndët e ndryshme	Numri i lëndëve
1	Autorizime	3
2	Marrëveshje bashkëpunimi dhe mirëkuptimi për bashkëfinancim	18
3	Memorandume bashkëpunimi dhe mirëkuptimi	7
4	Aneks Memorandumi me Agjencionin Kadastral	1
5	Kontrata	26
6	Kontrata për punë	30
7	Aneks kontratë për shërbime postare	1
8	Raporte të ndryshme	6
9	Njoftime	4
10	Njoftim për diskutim publik	2
11	Njoftim për takime publike	2
12	Formular të ndryshëm	3
13	Kalendar i dëgjimeve buxhetore	1
14	Plane të Punës	7
15	Raporte të Punës	7
16	Raporte 6 mujore të auditimit	2
17	Raport vjetor i auditimit	1
18	Raporti i progresit fizik dhe financiar	3
19	Urdhër për pagesë	1
20	Urdhëresa	1
21	Lista e të dhënave të dëshmorëve dhe viktimave të luftës	1
22	Letër konfirmimi për mbështetje	1
23	Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve	1
24	Formë e autorizimeve për listën e pagave	1
25	Shtojcë për programin për bashkëfinancim me donator	1
26	Formular për aplikim për trajnim	3
27	Formular i raportimit vjetor financiar 2024	2
28	Shkresa njoftuese	3
29	Planifikimi buxhetor për vitin 2025	2
30	Debate Publike	2
31	Dëgjime Publike	2
32	Kërkesë e Presidentes	1
	Totali i lëndëve	146

Nr.	Kërkesat e Kryetarit të Komunës drejtuar Ministrive dhe Organizatave tjera	Numri i lëndëve
1	Kërkesë për shpronësim të pasurisë së paluajtshme të cilën e menaxhon AKP-ja për MMPHI	5
2	Kërkesë për shpronësim të pasurisë së paluajtshme të cilën e menaxhon AKP-ja për MAPL	5
3	Kërkesë për trasimin e rrugës Pllajnik-livadhët e Radeshës për KFOR-in Turk	1
4	Kërkesë për inicim të procedurës për binjakëzim për Kuvendin e Komunës	2
5	Kërkesë për pajisje me leje parkimi “VIP” për veturat zyrtare të komunës së Dragashit, për MPB-AP	1
6	Kërkesë për mbështetje në angazhimin e 20 praktikantëve në QKMF, për agjencinë e punësimit	1
7	Kërkesë për ndërtimin e këndit të lojërave për fëmijë në ShFMU “Uina”, për KFOR-in Turk	1
8	Kërkesë për ndërtimin e një fushe sportive në fsh.Lubovishtë, për KFOR-in Turk	1
9	Kërkesë për trasimin e rrugës Radeshë-bjeshka e Radeshës, për KFOR-in Turk	1
10	Kërkesë për hapjen trasimin e rrugës Rrenc-Xërxe, për KFOR-in Turk	1
11	Kërkesë për kompletimin e transformatorit të rrymës në bjeshkën e f.sh.Zaplluxhe për KEDS	1
12	Ankesë lidhur me vlerësimin e gabuar të treguesve të performancës Komunale të komunës së Dragashit për komisionin e ankesave të MAPL-së Prishtinë	1
13	Kërkesë për hapjen trasimin dhe zgjerimin e rrugës këmbësore, për KFOR-in Turk	1
14	Kërkesë për furnizimin me zengjin të rrotave traktorët e komunës, për KFOR-in Turk	1
15	Kërkesë për zgjerimin e rrugës ekzistues në fsh.Radeshë, për KFOR-in Turk	1
16	Ankesë e kryetarit të Komunës për Hidroregjionin Jugor Sh.A. dega në Dragash	1
17	Kërkesë për futjen e rrugës Krushevë-Shishtavec nën menaxhimin e drejtorisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve-Prizren, për MMPHI departamenti i Infrastrukturës Rrugore	1
18	Kërkesë për ndërtimin e trasesë së rrugës Qollopek-Kapre, për KFOR-in Turk	1

19	Kërkesë për furnizim me pajisje të kuzhinës për restaurant “Tre Vëllezërit” nga fsh.Kuk, për KFOR-in Turk	1
20	Kërkesë për vazhdimin e datës për përfundimin e punimeve, për MAPL-në Prishtinë	1
21	Kërkesë për rehabilitimin e rrugës malore në fsh.Plavë, për KFOR-in Turk	1
22	Kërkesë për furnizim me pajisje për kabinet të informatikës në ShML Ruzhdi Berisha në Dragash, për KFOR-in Turk	1
	Total Kërkesa	31

Nr.	Kërkesat e ndryshme	Numri i lëndëve
1	Kërkesa MAPL-së dhe Drejtorisë së Thesarit	91
2	Konfirmime Drejtoria e Thesarit – Ministria e Financave	2
3	Formular për barazim mujor Ministra e Financave	6
4	Njoftime Ministra e Financave	2
5	Pyetësor i vlerësimit Ministria e Financave	1
6	Kërkesa për rekrutim – punësim	31
	Total Kërkesa	133

Nr.	Vendimet e Zyrës së Prokurimit	Numri i lëndëve
1	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës	38
2	Vendim për caktimin e ekipit për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës	42
3	Vendim për themelimin e komisionit për pranimin teknik të punimeve	98
4	Vendim për shpalljen e tenderëve	80
5	Vendim për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave për punime shtesë	22
6	Vendim për caktimin e zyrtarëve autorizues	10
7	Vendim për shpallje të aktiviteteve të prokurimit	1
	Total lëndët e prokurimit	291

PËRMBYLLJE

Viti raportues është karakterizuar nga një angazhim i vazhdueshëm në realizimin e objektivave strategjike të Komunës, në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe në forcimin e qeverisjes së mirë. Përmes planifikimit të kujdesshëm, menaxhimit të përgjegjshëm financiar dhe koordinimit ndërinstitutional, është arritur progres i dukshëm në disa fusha kyçe të zhvillimit lokal. Përkushtimi institucional mbetet i orientuar drejt rritjes së efikasitetit, transparencës dhe

llogaridhënies, si dhe drejt krijimit të kushteve më të mira për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social.

Ky raport shërben si bazë për planifikimin e mëtejshëm dhe për avancimin e prioriteteve zhvillimore të Komunës në vitin pasues.

Prioritetet tona kryesore për Dragashin vazhdojnë të jenë:

- Administratë efikase, e përgjithshme dhe me shërbime moderne;
- Organizim më i mirë i punës dhe efikasitet i plotë i administratës së Komunës;
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit;
- Realizim i planit të të hyrave të Komunës;
- Rritja e përkrahjes për bujqësinë dhe për fermerët;
- Zhvillimi i turizmit dhe ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse;
- Nxitje të investimeve dhe projekteve në turizëm;
- Trotuare dhe shtigje të ecjes për këmbësorë dhe biçiklistë;
- Investime për ndriçim publik;
- Rritje e cilësisë dhe investime në arsim;
- Investime në nyje sanitare dhe meremetim të shkollave;
- Bursa për studentë;
- Hartimi i PZhK-së dhe Hartës Zonale;
- Terrene të reja sportive dhe përkrahje e sportit, aktivitete të planifikuara me të rinjtë;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për investime të drejtpërdrejta për të mirën e qytetareve përmes krijimit të vendeve të përhershme të punës si dhe zhvillimit ekonomik;
- Bashkëpunimi me komunitetin fetar, shoqëritë civile OJQ ndërkombëtare, vendore dhe partner të tjerë.

Ju faleminderit!

Artan Loshaj: Faleminderit kryetar! Për moshën që e kije më ke çuditë je shumë vital! Edhe kot së koti nuk e ke fituar këtë mandat, ishalla edhe një mandat kështu. Por po më vjen çudi se qysh i

amnistove këta drejtorë, a janë të paaftë me lexue apo nuk po i lejon me dalë me folë, çka është puna këtu kryetar? Për këtë i kije 8 drejtorë, është mirë me ju lënë rend që edhe këta me folë se njëherë në vitë e kanë. Pasi që disa “smart” drejtorë edhe kur se kanë vendin këtu vijnë na pengojnë këtu. Sot lëri të folin këta sepse është dita e tyre, unë dëshiroj që t’i përfundoj fjalimin dhe pastaj t’i pres secilin drejtor së paku që t’i lexojnë, sepse besoj që shumica nuk e dijnë se çfarë raporti kanë, as nuk i kanë lexuar vetë. Po shkojmë në fillim te laptopat, kryetar plotësoni kushtet elementare që unë kur të vijë me 200 faqe material me e marrë laptopin në vend aty dhe me ma mundësue me mikrofon që me pas kushte unë sepse nuk mundi me dal unë secilin fjalim apo replik. Në qoftë se dalin drejtorat unë po shkoj në vend sepse i ka disa pyetje për ata. Unë e di që i kije disa drejtorë të SDU-së të cilët janë mbi ligjin dhe nuk guxon që t’ju japësh urdhëra por sot është dita e tyre njëherë në vit me raportue për punën një vjeçare.

Usmen Baldzi: Unë, kryetar, në këtë pikë kisha një propozim, por nuk u vendos në votim – ose ndoshta nuk e kuptova mirë kryetarin – nëse do të dëgjojmë raportet e drejtorëve të sapoemëruar. Pra, çfarë mendoni ju, pozicioni dhe opozita? Nuk është logjike që një person që vitin e kaluar, për shembull, ka qenë mësues ose ka pasur një funksion tjetër, tani të paraqesë raport për vitin e kaluar. Mendoj se kjo nuk është e drejtë. Nëse duhet, është mirë, por si individ nuk mund të ndryshoj vullnetin e kuvendit. Do të ishte mirë të marrim një përgjigje nga kryetari. Nëse kryetari mendon që drejtorët e sapoemëruar duhet të paraqesin edhe raportet edhe planet, atëherë lind një pyetje tjetër – nuk është logjike që në Drejtorinë për emergjencë raportin e nënshkruan ish-drejtori, ndërsa planin drejtori aktual. E njëjta gjë vlen për administratën, ku si raporti ashtu edhe plani nënshkruhet nga drejtori aktual. Nuk e di as se kush ka qenë drejtori për atë vit. Pa u futur në detaje të panevojshme, mendoj se do të ishte më mirë që propozimi im të miratohej. Për shembull, nëse marrim drejtorin e financave – ai vitin e kaluar ka qenë drejtori i mandatit të kaluar, dhe tani është sërish në këtë funksion. Një drejtues i tillë mund të prezantojë si raportin ashtu edhe planin. Ky ishte propozimi im. Sa i përket raportit të kryetarit, dëshiroj sërish ta falënderoj kryetarin për raportin e detajuar dhe për përpjekjen e bërë. Duke u parë edhe në prezantimin e tij, ishte një ekspozim më i mirë, qartë se ka marrë pjesë aktivisht në punën e tij. Pra, kryetari ka marrë pjesë aktivisht në punë. Dëgjoni me kujdes – shumica e drejtorëve, siç vuri re mirë Artan, nuk e di sa vërtet kanë marrë pjesë në përgatitjen e raportit. Por kjo është çështja e tyre kur vjen radha e tyre. Kryetar, kam vetëm disa pyetje që do të doja të më shpjegoni, që të mund të pranoj dhe të votoj, ose të bindem të pranoj raportin tuaj. Me partnerët Helvetas / Demos kemi financuar nënshkrimin

e marrëveshjeve për mbështetje financiare dhe të ngjashme. U realizua në Restelicë, por më intereson çfarë është bërë konkretisht, duke pasur parasysh që dimë se 70,000 euro janë ende në proces ankimimi. Nëse më kuptoni. Me partnerët Helvetas/Demos, në Restelicë dhe Radëshi, bazuar në ato grante, kemi bërë pajisje dhe aktivitete të tjera – por kur dimë që kemi në proces ankimimi edhe 70,000 euro, nuk më është e qartë çfarë mbulon saktësisht dhe çfarë është bërë deri tani. A janë këto fonde vetë të komunës prej 70,000 eurosh apo lidhen me këto grante? Çfarë ndodhi me këto fonde dhe çfarë është bërë deri tani? Nuk më është e qartë. Kam lexuar këtë buxhet mjaftueshëm gjatë disa ditëve, i kam kushtuar vëmendje, ju kam dëgjuar maksimalisht, dhe tani duhet të marr sqarime ose të bindem që të mbështes raportin tuaj.

Jetimët e Ballkanit, do të ishte mirë të dimë se cilat familje janë përfitues të marrëveshjes sonë midis komunës dhe partnerëve. Është e rëndësishme të kemi këtë informacion. Dhe gjithmonë do ta përsëris – nëse dimë dëmet e shkaktuara tek individët dhe emrat e tyre, kjo nuk është e ndaluar me ligj, as nuk është turp të dimë kujt do t'i ofrojmë ndihmë nga ndonjë projekt, emër për emër. Kjo vlen edhe për drejtoritë e tjera kur të vijë koha, por në rastin e Jetimëve të Ballkanit, duhet të dimë kush ka marrë dhe kush do të marrë ndihmën e caktuar, dmth shtëpinë. Në bashkëpunim me partnerët, në pjesën e raportit të muajit të gjashtë, kemi përfshirë edhe ekoregionin dhe kemi filluar mbledhjen sistematike të mbeturinave nga të gjitha fshatrat e komunës Dragash. Nëse është kështu, unë e përshëndes këtë dhe është mirë. Në raport thuhet se kjo është bërë – por mendoj se nuk është e saktë. Në oborrin e qendrës shëndetësore, pajisje fitnesi, kemi parë muskujt e dikujt, kemi kryer aktivitete dhe kemi ndjekur rezultatet, por në Drejtorinë për Shëndetësi, midis donatorëve nuk është përmendur Ambasada e Bullgarisë. Propozoj që drejtori ta shikojë dhe të korrigjojë këtë informacion nëse është e nevojshme. Më e rëndësishmja është se, sipas raportit tuaj, është e qartë që kam marrë pjesë në aktivitetet dhe kam ndjekur realizimin e projekteve. Komunës Dragash, ju keni thënë se kemi ndërtuar një “ujësjellës historik”. Për disa është historik, po, nuk e kundërshtoj. Unë kam kuptuar thelbin. Për të tjerët ndoshta nuk është historik, madje është pak i hidhur. Unë bëj pyetjen e mëposhtme: a mund të lidhen aktualisht të gjitha fshatrat me atë ujësjellës? Nëse projekti është përfunduar, duhet të mund të lidhen. Në raport thuhet se është përfunduar, prandaj nëse përkthimi është i dobët, kërkoj falje, por kjo është formulimi juaj, i referohem shërbimit. Duke cituar nga raporti: “Në shtator të këtij viti kemi përfunduar një nga projektet më të rëndësishme kapitale në historinë e komunës sonë – ujësjellës për 15 fshatra dhe zonën urbane të Dragashit, duke bërë një hap të rëndësishëm në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve tanë.”

Pyetja ime praktike: a është sistemi gati që fshatrat e rinj të lidhen dhe të përdorin ujin nga ky projekt, apo ende ekzistojnë kufizime teknike? Pyetja është: a mund të lidhen aktualisht të gjitha fshatrat dhe të përdorin këtë ujë? Nëse mund, atëherë projekti është vërtet përfunduar. Por unë e di që aktualisht nuk mund të lidhen, që do të thotë se raporti nuk është plotësisht i saktë. Pyetja e dytë, dhe për të sqaruar përgjithësisht – ne këtu do të diskutojmë dhe do të matim rezultatet për katër vitet e ardhshme. Ju uroj shëndet dhe sukses, por këtu të gjithë e dimë që çdo projekt duhet në fund të tregojë çfarë? Përdorshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij. A është projekti realizuar sipas planit? Sa i përket ujësjellësit, qytetarët thonë se uji nuk është i pastër dhe përmban baltë. Çfarë ka me filtrat? A është gjithçka realizuar sipas projektit? Do të ishte mirë të na informoni, për të mirën tonë dhe tuajën. Investimet kapitale – për këtë arsye kam kërkuar shtyrjen. Tani do të thoni që unë sulmoj, që jam kështu, ashtu... Mirë, unë jam ekonomist. Çfarëdo qofsha, ndoshta i veçantë apo jo, por jam ekonomist dhe kam qenë drejtor i Buxhetit dhe Financave. A duhet që të ardhurat dhe shpenzimet të përputhen në buxhet, zotërinj, në gjithë botën? Po, duhet. Tek ne nuk është kështu. Imagjinoni një çudi. Shoh që shumë nuk kanë lexuar – dhe e di që nuk kanë lexuar. Shumica, pa fyer ata që e kanë bërë. Në raportin e shkurtit, nga Drejtori për Financë dhe Ekonomi, morëm informacion – e kam atë raport. Këtu duket zoti Qamil. Në raportin vjetor, për të mos lodhur kuvendin, shkruhet: ishin planifikuar investime kapitale 4,615,581 euro (nëse gaboj, më demantoni), dhe realizimi ishte 4,113,831 euro. Kështu shkruhet në raport. Nuk kërkoj përgjigje, por nëse mendoni që nuk kam të drejtë, më demantoni. Më tej, në raportin e këtij viti të Drejtorisë për Urbanizëm: 4,340,860 euro, ndërsa realizimi është shumë më i ulët, 3,888,550 euro. Pastaj kam parë se çfarë nuk është realizuar – dhe përsëri tregon që nuk është e saktë. Nga ato 70,000 euro, për të cilat kam bërë pyetje tek kryetari, dhe dy projekte në komunë... Kam harruar, nuk dua të kërkoj tani, e di, shkruhet në raport. Në Opolje... Ato para ishin rreth 150,000 euro. Pra, mungojnë rreth 350,000 euro. Kur lexoj raportin e kryetarit, shkruan se është realizuar dhe paguar 4,483,115 euro. Nuk dua t'u flas keq këtu apo të akuzoj dikë – Allahu është dëshmitar. Por kjo nuk është mirë. Sepse mbi ne janë Agjencia Kundër Korrupsionit, Agjencia e Auditimit të Buxhetit të Kosovës, Agjencia Kosovare për Konflikt Interesash, organizata joqeveritare – të gjithë mbikëqyrin punën tonë. Mos ndodhë Zoti që të ketë probleme apo gabime... Do të më vinte keq nëse shkoj dikujt për vizitë dhe shoh gjëra të pa rregulluara, ura apo probleme të tjera infrastrukturore. Mendoj se duhet të reagojmë dhe të rregullohet. Nuk po sulmoj askënd, por është e rëndësishme që gjithçka të përputhet dhe që buxheti dhe raportet të jenë transparente dhe në

përputhje me rregullat. Nuk do të kritikojmë çdo gjë menjëherë. Do të vijmë të diskutojmë me ju dhe drejtorin tuaj, për të parë situatën. Nëse gabo, do të kërkoj falje publikisht. Kjo “përkallëzimi” – të gjithë themi, respektojmë procedurat, dhe kjo është për të mirën tuaj. Por çfarë po “përkallëzojmë”? Duhet të dihet saktësisht: 100 metra katrorë, me 13 euro. Nuk mund të “përkallëzojmë” në Brod dhe të mbetet e paqartë. Ejani dhe shikoni. A po përkallëzojmë apo po luajmë me fatin? Mos luajmë me fatin. Nuk është mirë. Nëse përkallëzojmë, duhet të dihet. 100 metra katrorë me 13 euro. Prandaj kam propozuar që të shqyrtojmë raportet pjesërisht. Sot vetëm kryetarin, nesër të vazhdojmë. Të na admirojë Kosova, Dragashi ka histori. Jepni emër konkret. Asfaltimi, për shembull: tenderi përsëri. Sa i përket trotuareve, shikoni vetë – në shqip shkruan: “Ndërtimi i trotuarit të Urës Dragash – Shajne, ndërtimi i trotuarit Dragash – Kukuljane Grant performanse.” Nuk ka, kryetar, nuk ka, ju mashtruan. Investimi në sport, pashë në Facebook që palestra sportive është përmbytur nga uji, drejtor i Urbanizmit kur propozon projekt, duhet të mendojë për nesër, jo si në Mlike, ku projektet shkaktuan përmbytje në gjysmën e fshatit Mlike. Ai kurrë nuk më ka dëgjuar dhe nuk do t’ju dëgjojë as ju. Kjo nuk mund të pranohet, askush nuk do. Ku janë pensionistët tanë, kategoria më e rrezikuar e komunës Dragash? Pse jo? Le të shkojnë në Durrës, Velipojë, edhe në Vlorë, pse jo? Pse t’u japim vetëm 10,000? Dhe kujt saktësisht t’ia japim? Shikoni, kryetar, këtu ndaloj tani sepse kjo është politikë. Nëse sulmoj, nuk do të merrja vota. Sepse nuk dua që tani përmes votimit... mund të flas, por unë jam kryetar partie dhe duhet të kujdesem. Kujdesem për shumë gjëra këtu. Kujdesem. Kryetar, këtë e kam thënë dhe ky është qëndrimi im. Ju lutem, mos thoni vetëm se kërkoj të dorëzoj kërkesa në zyra tek shërbimet. Pse të më dorëzojnë kërkesa? Nuk jam vetëm qytetar. Po, jam qytetar i kësaj komune, por nuk jam vetëm qytetar – kam edhe përgjegjësi si përfaqësues partie dhe si lider. Këtu është një propozim: nëse Kosova sot fiton ndaj Turqisë, të gjitha subvencionet t’i jepen Veldin Hodzhit nga Restelica, sepse çdo gjë tjetër nuk ka rëndësi. Çfarë sporti, çfarë “bakraçi”...? Do të ketë mendim subjektiv: “dua Ardenën”, “është nxënësi im”... kampioni i Kosovës, dhe edhe kur fle skija – 2000. Të mos hyjmë tek paratë për shahun, të mos flasim për ndeshjet. Ja, nuk do të vazhdoj më tej, nuk do. Ju lutem – faturat. Kjo ishte për ju, kryetar. Nëse jo, del që u jepni para për politikë të pastër. Nëse pyet Agjencinë për Konflikt Interesash, nga kjo do të lindë problem. Drejtori, drejtori i urbanizmit, është vëllai i tij anëtar i bordit të një organizate joqeveritare Milina, ndërsa ai personalisht është anëtar i bordit të një organizate tjetër joqeveritare, të mos gabo, duhet të kujdesem. E di, dhe ai e di. Kam qenë i përfshirë kur është vendosur kjo rregullore. Dhe kjo është konflikt interesi. Nuk

ndjek askënd, nuk e raportoj – vetë raportohet. Kryetar, menaxhimi dhe të tjerët, qëndrimi i OJQ-ve dhe gjithçka tjetër – të gjithë duhet të dorëzojnë raportet, siç e bëri KUD “Bresana”. Kam qenë verën e kaluar në festivalin ndërkombëtar veror. Duket, njerëzit luajnë, punojnë... Nuk do të hyj tani në detaje për dy apo tre euro, por e shoh dhe më pëlqen. Por ku është Gora, ku është kultura jonë? A do ta paraqesim kështu me muzikantë të rastësishëm? Jo, mos pranoni propozime të tilla. Më mirë që drejtoresha e kulturës të formojë një ekip, të krijohet shoqata kulturo-artistike “Gora” dhe të quhet qartë kështu, të punësohet një punonjës në Drejtorinë e Kulturës, që të ruhet identiteti dhe autenticiteti i kulturës sonë. Le të organizojë kulturën “Gore”, të bëjë një aktivitet si nusëria në Brod, si në Galici të Maqedonisë. Jepni, le të na shohë Kosova. Çfarë po fshihemi? Po mbështesim sot? Nuk është e vërtetë. Për Kosovën sot mbështet vetëm një pakicë e vogël njerëzish... E, përfundoj këtu. Sa i përket faqes së internetit dhe prokurimit – po i jepni autogol vetes. Faqja e internetit për prokurime publike nuk është e rregullt. Në serbisht, raporti i fundit është 5 maj, në boshnjakisht 00. Flasin për transparencën dhe qasjen në dokumente publike. Transparenca duhet të jetë e mirë për të marrë çmimin. Por duket qartë, unë shqetësoj këtu, jo të tjerët – mos shqetësoni njerëzit. Është mirë që kemi listën e pagave, sepse kemi informacion që në “Gorë” njerëzit marrin pagë, por jetojnë jashtë Kosovës ose nuk punojnë fare dhe marrin pagë. Konkursët nuk na jepen, anulohen, nuk pyetemi. Unë mbroj komunitetin, veçanërisht komunitetet jo shumicë – tregoni që i mbani, dhe unë do t’ju mbështes. Kryetar, sa i përket raportit tuaj – keni punuar, duket përpjekja. Gjithçka që është në raportin tuaj, tani është kopjuar në raportet e të tjerëve.

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! Realisht i çmojë dy delegetët të cilët po shprehin interesim për debat derisa po bëjnë pyetje dhe po kërkojnë sqarime mirëpo momentin kur po i tejkalojn këto kompetencat dhe dhe po fillojnë t’a marrin rolin e vetëvlerësuesit dhe të gjykatësit disa edhe mbajnë fjalime politike dhe aq më shumë aktrojnë këtu, atëherë i tejkalojnë edhe kompetencat e delegatit dhe po na qesin në pozita të palakmueshme. Drejtorat i raportojnë kryetarit dhe përpos që i raportojnë kryetarit, ata në çdo kohë i raportojnë edhe delegatëve kur ka nevojë, por kjo nuk do të thotë se nuk keni informata të nevojshme. Shumica e delegatëve marrin materialin në mënyrë elektronike dhe ata mund t’a bëjnë një koncept me pyetje dhe të dalin të kërkojnë sqarime për ne. Momentin kur nuk jeni të kënaqur me sqarim atëherë kërkon informata zyrtare ose drejtohuni dikund tjetër. Mua më vjen mirë që po e nisni debatin. Njëri prej delegatëve thotë për investimet kapitale dhe po kthehuni te raporti për financa, ku është një prej raporteve më të

mira të pasqyrave financiare. Në qoftë se nuk i shihni investimet kapitale nuk do të thotë se nuk egzistojnë. Ato investime kapitale përputhen i nderuari delegat, për faktin se një pjesë e tyre janë marrë nga përmbaruesi, në qoftë se e shikoni raportin financiar që ju kemi sjellur seancën e kaluar, të gjitha ato mjete kanë shkuar tek përmbaruesit privat. Por jo vetëm nga investimet kapitale por janë edhe nga mallrat dhe shërbimet dhe nga shërbimet komunale. Për këtë arsye komplet të dhënat përputhen, ku 93% e buxhetit të mallrave dhe shërbimeve është ekzekutuar në mënyrë më të mirë të mundshme. Pjesa tjetër e të hyrave është që pas 14 Dhjetorit inkasohen dhe nuk mund të hyjë në funksion dhe barten në këtë vitë, që do ta kesh bartjen dhe shpërndarjen e buxhetit të hyrave vetanake dhe do të mund t'a realizojmë këtë vitë. Gjithashtu është e vetmja Komuna e cila ka obligime të papërfunduara dhe të paparashikuara për vitin 2026 edhe pse përmbaruesi na ka atakuar në investimet kapitale dhe kët keni qenë të informuar të gjithë delegatët se ato para janë marrë me përmbarues dhe është atakuar projekti më i madhë i ujit mirëpo ne ja kemi arritë që t'i kryejm ato obligime gjatë vitit. Sa i përket, ne kemi dhënë raportet financiare dhe mund të japim edhe raportin narrativ, mund të ju shpjegojmë se sa sektor ka drejtorin e finacave por besoj se secili drejtor mund ta bëjë. Mendoj se u pranua nga delegatët heshtas se ata drejtor mund të raportojnë edhe vitin tjetër, por të njëjtin raport mund t'a kompenzojë kryetari për drejtorët që kanë qenë gjatë vitit të kaluar. Mua më vjenë keq të nderuar delegatë që shpeshherë aludoni në subvencione dhe në OJQ duke u munduar që foltoren me e politizue. Mua më vjenë keq, se në aspektin politikë ne kemi shumë rrespekt për vakatin por ti si kryetar e ke sjell në këtë gjendje. Nuk mund që drejtorin e kulturës ty të të krijojë shoqëri kulturo-artistike Gora ose Opoja, por janë vetë iniciativat qytetare që krijojnë këto shoqëri, ne mund t'i mbështesim. Kërkesat të cilat kanë ardhur nga komuniteti jo-shumicë janë investuar dhe janë pjesë e subvencioneve të përgjithëshme. Pra kur të aktroni këtu duhet të keni një bazë, dhe nuk mund që ne të ju krijojmë shoqëri kulturo-artistike. Cila shoqëri kulturo-artistike e Gorës që operon në Komunën tonë nuk është subvencionuar? Ju e dini këtë shumë mirë. Në seancat e fundit keni filluar të mbani fjalime politike por të shprehni një mëllef për dështimin tuaj politikë.

Granit Rifaj: Desha të ndërlihem me drejtorin sepse kur po folën për asamblenë po folën përgjithshëm, në qoftë se e ka me dikond le t'a thotë sikurse e tha në fund me kryetarin e Vakait, por me na mbajtë ligjërata dhe me na aktrue se çka është puna jonë sepse neve na ka votuar populli dhe jo ju, nuk mundish me na tregue, e kije pak gabimë! Në qoftë se dikush ka tregue këtu demagogji dhe politikë je ti pikërishtë. Gjithmonë janë fjalimet e tua që kanë ngjallur debate. Nuk

desha me ja fillue por pasi fole ashtu po t'i bëjë disa pyetje. Fole për Investimet kapitale janë krye, pasi t'i kemi bërë edhe herën e parë si p.sh.: stadioni i Blaçit i Pllavës, Rugën Kukajanit e shumë disa të tjera, keni dalë i keni argumentue këtu, pasi që keni thënë shpjegohen me fjalë, nuk po dëshirojmë me na i shpjegue me fjalë sikurse na i keni shpjeguar seancën e kaluar por dëshirojmë me na i argumentue me dokumente. Në qoftë se keni dalë dhe keni thënë se rruga Kukajan-Dragash keni dalë këtu edhe ti edhe kryetari e keni demantuar që kurse nuk ju ka lënë ministria dhe keni thënë se ato mjete kanë hyrë diku në fshatë. Janë bërë investime. A ka mundësi me na sjellë dokumentacion që i mbulon ato investime për me e ditë ne se ku kanë shkuar ato mjete? Pastaj vazhdojmë me të tjera, por njëherë në qoftë se ka mundësi këtë përgjigje. Ju faleminderit.

Shukri Myrtezani: Përsëritet për të gjithë! Sa i përket raportit të drejtorëve, unë mendoj që është mirë që ne pasi e kemi pranuar materialin më herët, edhe e kemi analizuar, për shkak se me kursye edhe pak kohë, kështu që është mirë me i bo pyetje konkrete të cilat kemi me i bo. Sa do vetë fakti që Usmen Baldzi kur po e zgjatë fjalimin nuk po kemi vullnet me ndëgju shumë. Edhe kryetari kur raportoi, një pjesë e madhe e delegatëve nuk kanë qenë të pranishëm në sallë. Pra, është mirë që të bëjmë pyetje konkrete, meqenëse e kemi pranuar materialin, edhe të na raportojnë drejtorët për punën ose për pikat të cilat ata kanë shfaqur interesim. Ju faleminderit.

Artan Loshaj: Pasi që nuk po dalin drejtorët me raportua, atëherë unë si delegat po ja filloj me pyetjet. Po ja filloj me bo pyetje dhe me siguri do të marrim përgjigje prej tyre. Po nisim me punën e kryetarit. Aq shumë sa është lavdëruar që ka punuar, por unë po dua ta pyes kryetarin edhe drejtorat se a ka pasur dikund ndonjë ngjetje. Pasi që vetëm lavdata kishte për këtë qeverisjen, pra në qoftë se është kështu si po e thëni ju, kanë me kërkue qytetarët nga komunat tjera me ardh me jetu në Dragash. Problemi është se, kur dëgjojnë qytetarët e tjerë se aq shumë keni punuar dhe e keni bërë këtë komunë atraktive, qytetarët tjerë do të kërkojnë azil politik dhe azil ekonomik këtu. Dhe po më vjen shumë mirë. Tek drejtorat e rinjë, kur tha aty se duhet mi amnistue dhe me i kursye dhe me i lënë me folë vitin tjetër. Kryetarin kur e kam pyet për drejtorat e rinjë, ku i gjeje prej Prizrenit dhe prej Beogradit. Ai ma tha se kam kërkuar drejtorë nga koalicioni, drejtorë me fakultet. Pasi që ka drejtorë që i ka sjell prej Prizrenit dhe Beogradit pesëqind kilometra me fakultet, atëherë le të dalin këtu dhe le ta lexojnë raportin dhe të përgatiten për seancat. Një pyetje për drejtorin e arsimit. A ka mundësi një listë të punëtorëve të arsimit sepse unë kam informacione, sikurse që ka edhe zoti Baldzi, që ka punëtor që është në listë të pagave dhe që jeton jashtë shtetit? Kështu që e di që keni me thënë jo nuk kemi të drejtë me e dhënë, unë nuk po kërkoj listë të pagave. Sepse e

kam lexuar aty diku që janë 436 punëtorë. Ajo lista me 436 punëtorë në tri-katër faqe aq na duhet. Pra në qoftë se nuk ma jepni, atëherë unë zyrtarisht do t'ju drejtohem që të ma jepni. Po shkojmë te Drejtoria e Shëndetësisë, ku kam punuar 26 vite dhe do ta kthehem aty. Dhe do t'i bëj pyetje drejtorit sepse në telefon po luan video-lojra. Dua t'ia bëjë një pyetje se a punon laboratorin në QMF në Brodosa dhe në faqen 132 para renovimit e vitit të 2025 janë bërë investime vetëm në rajonin e Gorës. Unë po dua të pyes kryetarin sepse e di që këtyre ju frigohesh me ju kërkue llogari pasi i ke në koalicion. A është drejtor i strukturave paralele të Vraniçit apo është drejtor i komunës së Dragashit? Lexojeni në faqen 132, ku thotë se kemi investuar vetëm në territorin e Gorës, në ambulanta dhe QMF. Këtu ka qenë edhe në mandatin e PDK-së. Për tri mandate nuk ka mundur ky që të bëjë investime në trevën e Gorës, por ky hanë këtu e mendimet i ka kah Serbia dhe trevën e Opojës e ka anashkuar komplet. Në faqen 140 në planin e punës përsëri te aktivitetet e ka vetëm pjesën e Gorës. Kryetar, edhe vitin e kaluar e kam bërë këtë shqetësim, kryetar le që nuk e ke qortuar, por e ke lavdëruar këtu duke thënë se e ke më të mirin më punëtorë. Ndoshta për bukurosh e kije, por për punëtor më të mirë mos e mbroj. Unë po i bëjë thirrje kryetarit dhe minoritetit se ky drejtor duhet të dënohet, ky trevën e Opojës e ka lënë anash dhe investon vetëm në Gore sepse aty e ka përqindjen. Në Blaç e Brodosa në s'mundet me shku atje ky e bënë ambulantën atje, shkon në Brod edhe po na vjen keq, dëno kryetar sepse duhet mu dënue. Mos të ma marrin për të keq sepse une punojë edhe bashkëjetoj me këta, ky e vjedhën trevën e Gorës.

Usmen Baldzi: Une ose jam keq perkthyer nga shërbimi i përkthimit, ose nuk më keni kuptuar si duhet sepse nuk keni ndjekur. Kam kërkuar nga drejtoresha e kulturës, duke marrë parasysh që subvencionet në “Gorë” shpenzohen pa aktivitete, pa rezultate dhe pa përfitim, që ndoshta do të ishte më mirë që ato subvencione të përqendrohen në Drejtorinë e Kulturës. Drejtoresha duhet të formojë një grup dhe të thërrasë ata njerëz që me të vërtetë e njohin kulturën dhe dinë çfarë do të thotë një shoqatë kulturo-artistike. Ky grup duhet të themelojë shoqatën kulturo-artistike “Gora”, e cila së bashku me Opoljen do të organizojë aktivitete në Dragaš dhe në mbarë botën. Nuk duhet që subvencionet të përdoren për aktivitete të organizuara “Mashalle” dhe “Džamballe” që duken si shpërdorim ose për t'i bërë njerëzit të qeshin. Kryetar, ju lutem kushtojini vëmendje të veçantë anëtarëve nga komunitetet jo-shumicë, që të mos tallen në mënyrë cinike dhe të mos pengojnë punën, dhe t'i paralajmëroni. Unë i njoh ata thellësisht. Zoti Qamil, nuk keni nevojë të hyni në debat me mua – të dy jemi ekonomistë dhe e njohim njëri-tjetrin prej kohësh. Nuk kam bërë asnjë pyetje të keqe apo të papërshtatshme.

Xhyllferie Bahtijari: Përshëndetje për të gjithë! Po mundohem që nga kjo foltore të jam sa më racionale, pasi që po shoh se kjo karakteristik, veti që duhet t'i përfaqësoj të gjithë asambleistët si përfaqësues ka humbur. Sidomos vlen të theksohet se ka humbur si veti nga asambleistët e komunitetit pakicë. Të cilët e kanë marrë si primat të përfaqësojnë duke grumbulluar një numër sa më të madhë të fjalëve të stërzgjatura. Jo të nderuar, sepse secilën herë që pyetet se a dëshiron që dikush ta marrë fjalën nuk do të thotë se duhet të dalësh vetëm të bëni propagand dhe të mundoheni që ta akuzoni pushtetin aktual i cili është i udhëhequr nga një kryetar i mirëfillt për të gjitha komunitetet. Jetojmë në një kohë ku vlerësohet cilësia e fjalës por jo edhe sasia, andaj ju kisha lut në maksimum që të mundohuni të mos propagandoni, të shpifni dhe të hedhni poshtë punën e kryetarit që kuse nuk po i rrespekton pakicat. Unë për veti nuk e di nëse ka ndonjë komunë në Kosovë që i rrespekton më shumë të drejtat e pakicave. Viktimizimi nga ana e juaj ka qenë veti edhe në mandatin e kaluar, ndonjëherë e kemi anashkaluar, ndonjëherë e kemi bërë kuse nuk po e ndëgjojmë, që tri seanca prej se kemi filluar, për shkak të moshës jam munduar që mos të ju kundërpërgjigjem mirëpo është e tepruar gjendja në të cilën po paraqiteni në foltore duke e akuzuar kryetarin aktual i cili po e bënë maksimumin në rrespektimin e të drejtave të pakicave. Mundohuni që këtë foltore ta përdorni sa më shumë në ngritjen e mirëqenies qytetare e jo në propaganda të ndryshme duke ua mbushur mendjen për ata që nuk e dijnë se sa të drejta keni ju si pakicë në këtë Kuvend. Ju faleminderit.

Afrore Vejseli: Përshëndetje për të gjithë! Për disa ditë me radhë në kushte me temperatura të ulëta nuk ka funksionuar ngrohja prap në shkollë. Nxënësit janë detyruar të zhvillojnë proceset mësimore në kushte të papërshtatshme. Kjo nuk është thjesht një problem teknik, por është një dështim institucional. Është e pamundur që në këtë vit që jemi të mos zhvillohen kushte minimale për proceset mësimore. Kur nuk garantohet as ngrohja, atëherë çdo diskutim për cilësinë e arsimit është i tepërt. Andaj, i kam disa pyetje të drejtëpërdrejta, se ku ka qenë Drejtoria e Arsimit në këtë rastë. Pse nuk është parandaluar kjo situatë dhe kush mban përgjegjësi për këtë neglizhencë? Duke u kthyer në raportin e punës për vitin 2025, poashtu do të ndalm tek Drejtoria e Arsimit. Ky raport, për fat të keq më shumë paraqet një listë të gjatë problemesh se sa një pasqyrë të rezultateve konkrete. Ajo që është më shqetësuese është fakti se shumica e këtyre sfidave nuk janë të reja, por ato janë të njëjta që po përsëriten vit pas viti. Vet drejtoria pranon për mungesë të stafit arsimor, zëvendësimet e stërzgjatura, problemat me pagesa, mungesa të psikologëve dhe asistentëve për

fëmijë me nevoja të veçanta. Kjo tregon qartë se kemi mungesë të menaxhimit efektiv dhe një plan serioz për zgjidhje. Andaj shtrohet pyetja: ku janë rezultatet? Si është e mundur që në vitin 2025 ende kemi angazhim pa pagesë në arsim? Pse nuk janë plotësuar pozitat për psikolog dhe për staf mbështetës nëpër shkolla? Dhe çfarë është duke bërë konkretisht për të ndaluar rënien e numrit të nxënësve? I nderuar drejtor, qytetarët nuk kanë nevojë për raporte që vetëm përshkruajnë problemet. Ata presin zgjidhje konkrete dhe përgjegjësi institucionale. Në vitin 2026 është e domosdoshme të ketë një plan të qartë për stafin profesional, të ndalohej menjëherë praktika e angazhimeve pa pagesë. Të sigurohen mbështetje reale për familjet me nevoja të veçanta dhe të ketë fokus në cilësinë e arsimit. Jo më pak e rëndësishme është edhe çështja e çerdhës. Më shumë do të flas për orarin që është i kufizuar ku është dy apo tri orësh, ku as pak nuk i përgjigjet nevojave reale të prindërve. Është e papranueshme, ku shumica e prindërve janë të angazhuar nëpunë. Institucionet nuk mund të funksionojnë me logjikën minimale të mundshme. Ato duhet të ofrojnë shërbime që realisht i shërbejnë qytetarëve. Kërkesa ime është që për planin e vitit 2026 të zgjatet orari i qëndrimit të këtyre fëmijëve minimumi katër deri në gjashtë orë. I nderuar drejtor, nëse vazhdojmë me këtë çasje, arsimi në komunën tonë rrezikohet të jetë vetëm një vendnumërim. Kërkohet më shumë përgjegjësi dhe më pak arsyetime dhe më tepër rezultate konkrete. Para se të përfundoj, dua të ngrej edhe një çështje. Ku më vjen një shqetësim gjithnjë e më shpesh nga mësimdhënësit. Mënyra se si ata trajtohen nëpër shkolla dhe mungesa e mbështetjes institucionale, nga ruajtja e autoritetit dhe disiplinës në proceset mësimore. Një sistem arsimor nuk mund të funksionojë nëse mësimdhënësit nuk ndihen të respektuar në punën e tyre të përditshme, për fat të keq nuk shoh masa konkrete për planin e punës për vitin 2026. Uroj që këto të merren parasysh nga drejtoria e arsimit. Ju faleminderit!

Qamil Kolloni: Granit pyetja është seriozisht shumë me vend, ti e din shumë mirë se për çdo kontratë ka një menaxher dhe duhet ta dallojmë raportin financiar dhe raportin të cilin po e kërkon. Është një komision i pranimit i cili në bazë të komisionit i cili e bënë konstatimin në vendin e ngjarjes, e bënë edhe raportin, e pastaj e pranon menaxheri, menaxheri koordinohet me zyrën e prokurimit dhe pastaj na sjellin në sektorin e financave. Ne nuk jemi auditor në vendin e ngjarjes. Pasi që e nënshkruan menaxheri, ne e bëjmë pagesën. Në qoftë se të duhen të dhëna të tjera, pikërisht ky projekt është ndryshuar, siç e ka sqaruar kryetari, është pjesë edhe e auditimit dhe i kemi dërguar të gjitha shenimet. Në çdo kohë jam në gjendje që me t'i sjell dokumentat. Tash unë nuk munda me t'i sjell në raportin financiar secilin dokumentacion veç e veç dhe komisionet të cilat

janë formuar për secilin projekt. Për secilin projekt është formuar komisioni dhe menaxheri. Pa nënshkrimin e menaxherit, pra kur nënshkruhet nga ana e menaxherit, është afati prej tridhjet ditëve për pagesë dhe ne jemi të obliguar me krye pagesën. Kemi edhe zyrtarin certifikues para se mu bo pagesa. Domethënë, ai e bën certifikimin e të gjithë dokumentacionit dhe e sheh se është valide pagesa, atëherë ne e bëjmë ekzekutim. Pra, delegatët duhet ta dallojnë se çka është raporti financiar dhe çka është projekti për investimet kapitale.

Ai ka thënë se mjetet nuk janë përdorur për investimet kapitale. Dhe për këtë arsye unë dhash shpjegim se i kemi 129 mijë euro për lëndët përmbartimore dhe kur i kemi bërë barazimet e pasqyrave financiare, ne jemi njëra prej katër komunave më të mira dhe marrim grantin pikërisht sepse na përputhen pasqyrat financiare. Prandaj kjo nuk është demagogji, dhe unë insistoј me mbrojtë punën e një kolektivi. Sepse aty punojnë 12 zyrtarë të cilët e bëjnë një punë të ndershme dhe unë si drejtor jam i obliguar që ta mbroj punën e tyre.

Granit Rifaj: Tash do t'i cekim projekt për projekt se çfarë kërkoј unë. Duke filluar nga stadiumi në fshatin Blaq, 70 mijë euro janë në pyetje, nëse nuk gabohem. Nuk është investuar asgjë në stadiumin e Blaqit. Keni thënë diku tjetër është investuar, ti edhe kryetari. Unë nuk e di, por është me të ndëgjuar. A ka mundësi me e ditë se çfarë është investuar dhe ku kanë shkuar ato mjetet? Po ashtu edhe te stadiumi i fshatit Pllavë, shuma është 50 mijë euro, diçka është punuar aty. Nëse bënë me ditë me dokumentacion se çfarë është punuar. Pastaj rruga Kukajan-Dragash. Keni thënë sepse nuk është punuar aty pasi që nuk ka lejuar ministria. A bënë me ditë se çfarë është punuar aty, sepse në raport, na shkruan se është bërë ajo rrugë. Edhe te rruga për në fshatin e Kosavës, ndoshta nuk e ke vërejtur atyre, pasi që përditë kalon andej për në fshat. A bon me e ditë se kush i ka pranuar dhe çfarë është pranuar. Se ti si drejtor shumë mirë po thuash se vinë raportet, vinë pagesat dhe ti ke për detyrë që t'a paguash patjetër. Por neve na intereson se ata çfarë kanë pranuar. Në qofse është pranuar, për shembull, rruga Kukajan-Dragash, ta shohim çfarë është pranuar dhe çfarë është punuar atje. Por edhe nëse ato mjetet janë rialokuar dikund tjetër, dhe janë destinuar dikund tjetër ato mjete, unë e di që sipas ligjit atë rialokimin e bënë Kuvendi. Pastaj, nuk kam marrë përgjigje për kompensimin e ekonomive familjare. Tek kompensimet ju punën e juaj e keni bërë dhe ju përgëzoј, por prej qeverisë kemi pritur dhe sa herë keni thënë se nuk është kompensuar asgjë. Por ne, kur kemi qenë në pushtet, sado pak i kemi kompensuar. Prandaj po pyes, a keni ndonjë mundësi me i kompensue ju? Pastaj pyetja tjetër, kryetari na tha për materialet që delegatëve të rinjë ju është dërguar materiali. Pra unë jam delegati i ri, nuk ka lidhje se a kam qenë

apo e kam pas dikënd. Mua nuk ma keni dërguar materialin. Më preki pak ajo që keni thënë se po i reduktoni shpenzimet. Kemi plot punë të tjera ku mundim me i reduktuar shpenzimet, si p.sh. shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit, meditet etj. Nëse kanë mbetë për letër, unë ju sjell nga dy pako letër. Pastaj te projekti i ujësjellësit, ju keni thënë se është përfunduar projekti i ujësjellësit, por disa thonë që nuk është kryer, disa po, disa të tjerë thonë që janë dëmtuar rrugë, ka kanale ende të pa-mbuluara. A është e vërtetë kjo, apo po bëjnë propagandë qytetarët, sikur se ne asambleistat këtu? Tjetër, ju keni thënë se jemi Komuna më e mirë për respektimin e të drejtave të minoriteteve, ju përgëzoj, se jeni komuna e vetme në Kosovë që komplet strukturat paralele i keni riintegruar dhe i keni legalizuar në institucionet komunale. Bravo ju qoftë. Ju faleminderit.

Usmen Baldzi: Gjithçka që kam diskutuar dhe dëgjuar deri tani mund të kalojë, por një akuzë të tillë që mora nga zonja e respektuar, sinqerisht nuk e prisja. Fjala “viktimizim”, nëse jeni të vetëdijshëm se çfarë do të thotë – dhe e di që jeni – është e rëndë për një kolege, një person të ri, një grua që e ka... Kam pyetur për përvojën politike, ishit në mandat të kaluar. Viktimizimi është një fjalë shumë e rëndë, por kur shikoni buxhetin tonë, ka vend që të reflektoni mbi të. Në regjistrim ka 39, më parë 41% pakica në Dragaš ose jo shumica, ose si të doni. Nëse buxheti nuk është shpërndarë në atë përqindje, atëherë ka vend për diskutim. Por me sjelljen tuaj, unë u ofendova ndryshe. Ju dëshironi të bëni segregim ndaj meje. Nuk do të mundeni. Dhe kjo nuk është përpjekja e parë. Kanë provuar edhe dy të tjerë. Mos më detyroni të dal në publik.

Bexhet Xheladini: Ju e dini që drejtorat i përgjigjen kryetarit edhe ata i raportojnë kryetarit dhe kryetari e dha një rezymë të shkurtër të punës së kabinetit dhe qeverisë komunale. Do të thotë, une bëra një përmbledhje të punës një 10% të punës që e kemi bërë. Dhe ju raportet e drejtorave i keni marrë të gjitha, i keni lexuar dhe i keni parë, por edhe gjatë tërë vitit keni pasur mundësi me e përcjellë punën tonë. Ju keni të drejtë me pyetë sepse ju ka përzgjedhë populli. Këtu fjala e juaj duhet me ecë, kurse ne jemi në shërbimin tuaj dhe jemi të obliguar që t'ju përgjigjemi, në Kuvend politik nuk duhet me bo, pasi që edhe unë nuk jam duke bërë politik në Kuvend. Pra, edhe njëherë po ju them se drejtorat më përgjigjen mua, po ashtu zyra për barazi gjinore, zyra për komunitete si dhe zyra ligjore më përgjigjen mua. Unë në raportin tim që e dhashë, u mundova që t'i përmbledh të gjitha këto zyra. Edhe mendoj se duhet të jeni të kënaqur me atë qëfar e thashë.

Unë tash po ju jap përgjigje për disa pyetje që ju i keni bërë për Jetimat e Ballkanit. Unë kam pasur një takim me kryesuesen dhe kemi shkruar me qëllim që ta vazhdojmë bashkëpunimin, sepse ne e kemi pasur një bashkëpunim jo vetëm ne, por edhe qeveria e kaluar me Shoqatën Jetimat e

Ballkanit. Edhe ne para dy viteve kemi ndërtuar pesë shtëpi për skamnorë dhe kemi dashur që ta vazhdojmë prapë këtë praktikë për vitin që po vjen. Jemi pajtuar me ata që në qofte se ne gjejmë mjete financiare për vitin që vjen, kjo shoqatë do të jetë në gjendje që ta financojë edhe në të ardhmen për skamnorët. Gjithashtu, ne kemi biseduar edhe për një projekt kapital shumë të rëndësishëm për komunën tonë. A do të realizohet ai apo nuk do të realizohet, nuk e di, por jemi në rrugë të mirë që të diskutojmë për këtë çështje. Sa i përket mbeturinave, është e sigurt që vitin e kaluar, në Shtator, pas një bashkëpunimi që e kemi bërë me Ekoregjionin, ne i kemi përfshi në sistemin e grumbullimit të mbeturinave të gjitha fshatrat. Kush nuk beson mundet me shkue në teren me e vërtetue. Është paguar edhe vitin e kaluar, por edhe këtë vit është duke e bërë komuna. Prej vitit të ardhshëm këto fshatra do të kyçen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave edhe pagesën do ta bëjnë ekonomitë familjare. Sa i përket asaj që është ndërtuar në oborrin e QKMF-së, si e quajnë ata qendër e fitnessit të hapur, atë e ka financuar 100% Ambasada Bullgare dhe marrëveshjen e ka bërë Ambasada Bullgare me kryetarin e Komunës, dhe vetëm vendi ku është implementuar ky projekt i takon QKMF-së. Kështu që Drejtori i Shëndetësisë aty nuk ka pasur qasje. Ka pasur qasje Kryetari i Komunës dhe Zyra për Komunitete dhe është duke u implementuar ky projekt. Ambasada Bullgare nuk është i vetmi projekt që e ka bërë. Në kohën e pandemisë ka sjellë shumë pajisje. Kur ka qenë në pushtet PDK-ja. Gjithashtu në kohën sa kam qenë unë, Ambasada Bullgare i ka implementuar edhe dy projekte të tjera. Ka bërë renovimin e shkollës fillore në fshatin Kërstec edhe ndërtimin e një parku të lojrave për fëmijë.

Sa i përket ujësjellësit për pesëmbëdhjetë fshatra, u pyet këtu se a janë të kyçura të gjitha fshatrat. Fshatrat të cilat kanë pranuar të kyçen, janë kyçur të gjitha fshatrat, ndërsa fshatra të cilat nuk kanë pranuar të kyçen janë fshatra të rajonit të Gorës. Ujësjellësi është i çuar deri në rezervuar dhe ata kanë hezituuar dhe po hezitojnë që ta kyçin sot e kësaj dite, përveç një fshati i cili më duket se është fshati Vraniç. Kurse fshatra tjerë e kanë ujësjellësin e çuar deri te rezervuari dhe nuk pranojnë mu kyçë. Mirëpo, këtë vit ne do t'i kyçim dhe do ta çojmë ujin deri në rezervuar që me një valvul do ta mbyllim. Kur kanë nevojë ata me shfrytëzue këtë ujë, mundin me e shfrytëzue, mirëpo ata po frikësohen se do t'i fusim në sistemin e pagesave. Megjithatë, ne e kemi quajtur ujin deri tek rezervuarët e të gjitha këtyre fshatrave. Tek subvencionet u përmendën pensionerët. Unë si kryetar i Komunës, shoqatën e pensionerëve e kam subvencionuar në bazë të kërkesës së tyre në vlerën pak diçka nën një mijë euro. Nuk kam të drejtë me ligjë më shumë se një mijë euro. Ndërsa subvencionet tjera që janë mbi një mijë euro që i ka në kompetencë drejtoria e Kulturës, ato bëhen

me thirrje publike. Kurse subvencionet që i lëshon kryetari, bëhen me kërkesë. Sa i përket subvencioneve në Drejtorinë e Kulturës, e përmendët konfliktin e interesit. Unë ta garantoj që subvencionet e ndara në pjesën e Gorës dhe të Opojës nuk ka konflikt interesi. Është bërë hulumtim i cili ka pasur zëra, sikur ju që e thatë, është vërtetuar se nuk ka konflikt interesi, por kush dyshon mundet me i fillu procedurat edhe me e pa që kjo çfarë po them unë është e vërtetë. Sa i përket rrugës Kukajan-Dragash, kjo rrugë është përmendur edhe herën e kaluar. Unë e kam sjell dokumentacionin këtu dhe ju e keni parë. Por edhe një herë po deklaroj se është vetëm emri i projektit, por në kuadër të këtij emri është i paraparë ndërtimi i një muri mbrojtës në Kukajan dhe kubëzimi i disa rrugëve në fshatin Kukajan. Edhe muri mbrojtës, por edhe kubëzimi janë realizuar dhe pagesa është kryer. Dhe kush nuk beson mundet me kërkuar qasje në dokumentet zyrtare me e vërtetue këtë që po e them se është e vërtetë. Dhe këtu nuk ka asnjë lloj keqpërdorimi. Sa i përket investimeve në rrugën Dragash-Kukajan. Po ashtu edhe në fshatin Radesh u përmend aty janë të parapara dikund shtatëdhjetë mijë euro, ka qenë një projekt dyvjeçar. Dhe në momentin e fundit, kur zyra e prokurimit ka vendosur që t'ia japë një kompani vendore, lokale, një kompani tjetër është ankuar në OSHP dhe lënda është tejzgjatur dhe ka ardhur fundi i vitit. Po për fat të mirë ato mjete nuk na kanë humbur. Me ato mjete ne kemi bërë pagësën e kontratës kolektive dhe ai projekt tash vazhdon dhe e kemi lidhur kontratën me kompaninë e cila e ka fituar tenderin dhe ky projekt do të realizohet këtë vit. Sa i përket listës së punëtorëve të arsimit që është kërkuar, unë nuk e di nëse e kemi bazën ligjore për me j'au dhënë. Por, me sa e di unë, nuk ka punëtor të tillë që jetojnë në botën e jashtme dhe marrin pagë këtu. Por ka punëtor të cilët kanë qenë mësimdhënës pastaj kanë shkuar jashtë dhe ata kanë përfituar pagë deri në momentin sa kanë qenë në arsim. Por drejtori i arsimit sigurisht që ka informata më të sakta dhe do t'i paraqet këtu. Sa i përket laboratorit, se a punon laborator në Brodosanë, nuk punon. Do të bëjmë përpjekje që ta aktivizojmë. Sepse punëtori i cili ka punuar deri më tashë e ka zgjedh opsionin që të jetë asambleist dhe jo të jetë punëtori i QMF-së. U përmend disa herë çështja e shërbimeve në shëndetësi, po përmendet shpeshherë drejtori i shëndetësisë. Ju, siç e dini, edhe me dokumentacion jemi komuna më e mirë në Kosovë sa i përket ofrimit të shërbimeve shëndetësore primare pas Mamushës. Vitin e kaluar janë bërë investime vetëm në pjesën e Gorës. Kur bëhet ndarja e buxhetit, 41.3% bëhet ndarja për komunitetin jo-shumicë dhe komuniteti jo-shumicë ka të drejtë që projektet e tyre për investimet kapitale ti ndaj aty ku ata e shohin më të arsyeshme. Dhe drejtori i shëndetësisë është i asaj pjese

dhe e njeh më mirë se ku ka nevojë të investohet. Dhe këtë vit do të investohet më tepër në rajonin e Gorës sepse aty ka më tepër nevojë, pasi që në vitin 2023 ne kemi investuar më tepër në Opojë. U përmend problemi i shkollës së mesme të ulët në Dragash dhe çerdhës, Lëvizja Vetëvendosje e ka bërë një reagim. Nuk e di se a ka bërë reagimin në emër të Vetëvendosjes apo në emrin e vet Uran Halimi. E kam lexuar atë reagim dhe ne e kemi bërë një sqarim publik si Komunë. Përsëri ka pasur një reagim tjetër, por edhe sot ka pasur reagim nga një asambleistë nga radhët e Vetëvendosjes. Tek reagimi i zotit Uran Halimi ka pasur shumë të pavërteta. Është e vërtetë që ka pasur probleme me ngrohje, por asnjëherë aty nuk është ndërprerë mësimi, as në çerdhe, por as edhe në shkollën fillore. Kemi pasur problem me furnizim me pelet. Arsyeja është sepse ka qenë kontrata tri-vjeçare dhe ky është viti i tretë i kontratës me këtë kompani. Kur e kemi nënshkruar marrëveshjen, çmimi i peletit ka qenë nën 250 euro dhe tash çmimi është diku 400. Kështu që kompania ka hezituar, edhe pse jemi drejtuar zyrtarisht, me na sjellë peletin për vitin 2026 por kompania nuk e ka sjellë. Kompania nuk ka të drejtë sepse shkruan në kontratë se ata duhet të sjellin për vitin 2026, 55 ton pelet. Kështu që, ai mundet me sjellë edhe në Shtator. Por megjithatë, ne e kemi zgjidhur problemin me kaloriferat edhe me ngrohjen ka qenë problemi vetëm një ditë. Dhe të nesërmën ka ardhur peleti 4 ton dhe ngrohja ka funksionuar edhe në shkollën fillore, por edhe në çerdhe. Kështu që është e drejtë e juaja me reague, sepse kemi pasur problem me furnizim dhe problemi është zgjidhur. U përmend edhe mungesa e psikologëve, siç e dini, ne kemi punësuar për herë të parë tre psikologë. Me sa e di unë, një ose dy janë në gjimnaz, edhe dy janë në shkollat e mesme të ulëta. Njëri është në fshatin Brodosanë dhe njëri është në Bellobrad. Po ashtu kemi të punësuar një ose dy mësimdhënës për fëmijët me nevoja të veçanta për më tepër do të përgjigjet drejtori. Sa i përket zgjatjes së orarit të çerdhës, drejtori do t'a japë një përgjigje. Është një kërkesë me vend dhe kjo duhet të ndodhë. Sa i përket pagesës së dëmeve të vëshimeve, delegati nga radhët e PDK-së tha se kur kemi qenë ne në pushtet, ne si Komunë e kemi bërë pagesën. Është e vërtetë që ju e keni bërë pagesën, por është edhe një e vërtetë tjetër se në atë kohë ka qenë kryeministër z.Avdullah Hoti. Unë dua të bëjë një dallim mes z.Avdullah Hotit dhe z.Albin Kurtit. Në atë kohë Avdullah Hoti j'au ka lëshuar juve si Komunë paratë sepse ka qenë pandemia. Komuna pastaj mjetet e qeverisë i ka ndarë. Jo mjetet e juaja, kjo që po e them është 100% e vërtet. Kështu që, me ligjë është e obliguar qeveria me e bo këtë. Kurse dëmet që janë bërë para një viti e gjysmë në infrastrukturë publike me mjetet tona të mallrave dhe shërbimeve i kemi kryer. Të gjitha dëmet që janë bërë në infrastrukturë publike, kurse dëmet në ekonomitë familjare ne nuk kemi para me i

pague dhe nuk është obligim i jonë. Por edhe kryeministri kur ka qenë tek ne në vizitë, ka thënë që do ta kryej. Nuk e ka kryer, por shpresoj që do ta kryej. Unë kam besim që ai do ta kryej. U përmendën strukturat paralele. Nuk është mirë që po përmendën, këtu në komunën e Dragashit nuk ka struktura paralele. Strukturë paralele në komunë nuk ka dhe të gjithë drejtorat të cilët i ka propozuar JGP-ja e që i kam pranuar unë janë drejtorë të cilët janë do të thotë qytetarë të komunës së Dragashit, qytetarë të Republikës së Kosovës të cilët janë bërë asambleistë me ligjet e Republikës së Kosovës dhe këta janë qytetarë të barabartë sikur unë edhe ti. Kështu që unë i trajtojë kështu, këta të gjithë i pranojnë ligjet e Republikës së Kosovës i pranojnë shërbimet që i ofrojmë ne edhe shërbimet shëndetësore, sociale edhe të Komunës. Kështu që jemi Komunë shembull për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

Unë jam i kënaqur shumë me punën e drejtorëve të cilët i kam emëruar unë. Jam i kënaqur me punën e nënkryetarit të komunës nga komuniteti jo-shumicë. Jam i kënaqur me zëvendëskryesuesin, me asamblistët e komunitetit jo-shumicë, kështu që në këtë drejtim unë si kryetar nuk e kam asnjë problem. Sa i përket webfaqes, webfaqen ne e mbajmë në dy gjuhë. Edhe prokurimi punon në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës. Tash i ftojë drejtorat të dalin dhe të përgjigjen aty ku unë s'kam mundur të jap përgjigje.

Ndërkoh e kemi siguruar dokumentacionin e nevojshëm për rrugën Kukajan-Dragash, e kemi siguruar kontratën, mundeni me marrë, ja u jap si kopje. Ky projekt është i realizuar nga zyra e prokurimit me kërkesë të Komunës, ka kushtuar dikund afër 34 mijë euro dhe në këtë projekt është ndërtuar muri mbrojtës në gjatësi prej 80 metra edhe kubëza afër 800 metra katrorë. Kështu që të gjithë ata të cilët kanë bërë propagandë, sidomos z.Nexhmidin Sejdilar, nëpërmjet rrjeteve sociale, kanë bërë propagandë me qëllim që të përfitojnë ndonjë poenë politike, por këtu gjdo gjë është transparente dhe është realizuar në tërësi dhe është kryer edhe pagesa.

Gjithashtu, po ashtu pyetja e parashtruar nga Graniti, ku tha se për dëmet nga vërshimet në vitin 2020 i ka kryer nga buxheti komunal, po ashtu e kemi siguruar dokumentacionin të vitit 2020, në kohën kur ka qenë pandemia, në radhë të parë, Parlamenti i Republikës së Kosovës e ka bërë plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 07-L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. Do të thotë është bërë plotësimi i ligjit që me i leju e komunat me ju lëshu mjete nga rezervat shtetërore për me bo pagesën e shpenzimeve. Pastaj ministri i Financave në atë kohë ministrja e cila ka qenë në atë kohë është z.Hykmete Bajrami, i ka alokuar komunës

së Dragashit mjete nga mjetet rezervë 489.955 euro dhe me këto mjete komuna e Dragashit, mes tjerash i ka paguar edhe dëmet nga vërshimet.

Granit Rifaj: Unë nuk e kontestova që qeverisja nën udhëheqjen e z.Avdullah Hotit një pjesë të mjeteve e ka dhënë por ajo nuk është as gjysma e mjeteve që janë shpërndarë d.m.th mjetet janë ndarë prej xhirollogarisë të Komunës, ka pas mjete që janë ndarë prej subvencioneve, ka pas mjete që janë kthyer prej ligjit të pagave që nuk është miratuar edhe ka pas mjete prej një fondi që e kanë pasur këto komunat më të vogla. Aty jam me ju, por pagesat i ka kryer komuna e Dragashit, nuk thash pse ju nuk po i bëni por thash se këto kompenzime i takojnë qeverisë, në qoftë se keni ndonjë mundësi së paku t'i kompenzojmë ekonomitë familjare.

Usmen Baldzi - Gjithçka deri tani që kemi diskutuar dhe dëgjuar mund të kalojë, por dua të bëj disa sqarime dhe pyetje. Jemi të lodhur, ka nervozizëm, atmosfera nuk është e mirë, dhe kjo nuk është e dobishme, por shpresoj se koha do ta rregullojë. Direktorati i Administratës duhet të kontrollojë faqen e parë të raportit, i bërë në shkurt 2025, dhe të korrigjojë gabimet. Kjo tregon që raporti është bërë me kopjim dhe ngjitje ("copy-paste"). Nuk është e qartë se kush është ish-drejtori që ka nënshkruar si plan dhe raport. Duhet të vendosim një qëndrim: a do të nënshkruajnë raportet drejtuesit e rinj dhe të vjetër? A është kjo në përputhje me ligjin dhe me udhëzimet e ministrisë? Pyetje ime nuk është sulm, por kërkim sqarimi. A është më mirë që drejtuesit e rinj të nënshkruajnë vetëm planin, ndërsa ata të vjetër ose të rinj dhe të vjetër të nënshkruajnë raportin dhe planin? Nuk është e njëjtë: nëse nuk kam qenë drejtor vitin e kaluar, si mund të nënshkruaj raportin? Së dyti, për arsimin: për licencat, vaktet e ngrohta dhe kompensimet për komunitetet jo-shumicë, a ka probleme ligjore me gjykatat, avokatët, mësuesit apo me komunën? Nuk është paguar asnjë kompensim, dhe për këtë Direktorati e ka shënuar si sfidë. Gjykatat kanë përfituar shumicën e fondeve për pagesa ndaj komunitetit shumicë, jo viktimizim. Drejtorati i Urbanizmit – ka dallime midis vlerës së investimeve kapitale në raport dhe realizimit të tyre sipas raportit të presidentit dhe drejtorit të financave. Duhet të korrigjohet. Për realizimin thuhet 89%. Në pjesën e rrugëve të fshatit Pllavë dhe Kuklibeg nuk ka vlerë, ndërsa për Radaš ka 70.000 euro. Dua shpjegim nga drejtori. Lejet e ndërtimit nuk kanë numër dhe duket se janë bërë thjesht për formë. Janë dhënë për ndërtim privat apo mbi pronë publike? Adresat: 28.894 banorë. Në regjistrim total i komunës? Nëse përdoren për zgjedhje dhe regjistrim në diasporë, kjo mund të jetë problem. Përmes sistemit ARIS, mbi 30.000 qytetarë kanë konfirmuar adresën e tyre zyrtare, ndërsa popullsia e komunës është 28.894 – duket e paqartë. Komisioni për shitjen e apartamenteve: vetëm 5 raste të përpunuara.

Duhet të dihet kush i ka marrë. Në përfaqësim ligjor janë regjistruar 200 raste. Drejtori i Shëndetësisë – një propozim u bë në Komitetin e Sigurisë dhe u miratua me votim. Çfarë ndodh me projektet për fëmijët nga diaspora? U mbledhën email, numra kontakti dhe u përdorën për votim nga diaspora. Pjesa më e madhe e instrumenteve është në duart e partisë shumicë dhe LDK si partner koalicioni duhet t'i mbrojë.

Veton Halili: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket në faqen e parë apo të dytë se ku shkruan muaji Shkurt, po du mi tregue z.Baldi se raporti është përgatitur në atë kohë dhe është dërguar në kuvend në muajin Shkurt dhe për atë shkruan muaji Shkurt 2025, ndërsa sa i përket nënshkrimit të raportit, unë e kam cek që ky raport është përpiluar në bazë të dhënave që janë dërguar nga sektorët, pra secili sektor dërgon të dhëna dhe unë i nënshkruaj. Ju faleminderit!

Zeni Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Më janë parashtruar disa pyetje për Drejtorinë e Arsimit dhe jam i obliguar që t'ju përgjigjem. Pjesën më të madhe të përgjigjeve e dha edhe kryetari. z.Artan, e di që ti e ke një përvojë të gjatë si delegat i Kuvendit. Ligjërisht, ty ta jep ligji që ta bësh kërkesën. Nëse ju dyshoni se ka në atë listë ndonjë person që është jashtë dhe merr pagë, lirisht mund ta bëni një kërkesë për çasje në dokumentet zyrtare. Nuk ta mohojmë atë. Kurse sa i përket të nderuarës, përgjigjen rreth peletit ta dha kryetari. Kurse sa i përket raportit, unë nuk e di se çfarë raporti po kërkon ti. Raporti është një përmbledhje e punëve dhe aktiviteteve të sektorëve dhe njësisë, ku janë përfshirë të gjitha punët dhe aktivitetet nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor të vitit 2025. Aty i kemi paraparë rekomandimet, ato që të shqetësojnë ty edhe sfidat me të cilat jemi ballafaquar dhe i kemi parashtruar për vitin në vijim. Kemi bërë pyetje edhe rreth psikologëve, kryetari e dha përgjigjen, ka thënë tre ndoshta ka gabuar, ne i kemi pranuar katër. Domethënë, një e kemi në Brodosanë, një në fshatin Bellobrad dhe dy në shkollën e mesme. Kurse sa i përket asistentës për fëmijë me nevoja të veçanta, me të vërtetë e kemi problem, sepse e kemi cekur edhe aty në raport. Jo vetëm aty dhe kemi bërë kërkesë edhe në ministri. Mirëpo, ministria po heziton dhe deri më tash neve na ka ndaluar. Para tri viteve, kur unë e kam marrë detyrën e drejtorit, e kam gjetë një kërkesë për 3 asistent, një këshilltar të karrierës dhe një specialist të IT-së, z.Vetim ka qenë drejtor i Administratës dhe e dinë shumë mirë pasi që na është refuzuar. Mirëpo, ne kemi tri asistentë që punojnë një në fshatin Brodosanë, një në Blaç dhe një në shkollën Fetah Sylejmani në Dragash. E kemi edhe ekipin komunal për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe e kemi bërë vlerësimin e një nxënësi me kërkesë të drejtorit të shkollës së mesme të lartë të gjimnazit. Kemi kërkesa edhe nga Blaçi për dy ose tre dhe sot kemi filluar punën që komisioni të

merret me ta dhe të bëjë vlerësimin e tyre. Sa i përket çerdhës, çerdhja sa po u formua. Ku pas shumë përpjekjeve, fati ishte që ne, tash po bjenë me u lavdërue por në fakt ashtu është që ne e kemi bërë funksionalizimin e çerdhes. Ne i kemi bërë kërkesë ministrisë që ta kompletojmë edhe zyrën por edhe krahas zyrës edhe mundësit tjera buxhetore edhe të kuadrove sepse nuk është problem që ta zgjatim edhe orarine punës, përpjekjet tona janë të vazhdueshme mirëpo nuk kemi përkrahje deri më sot. E kemi bërë propozimin që t'i vendoset edhe emri këtij institucioni shkollor dhe presim këto ditë që të na kthejë përgjigjen. Sa i përketë trajtimit të mësimdhënësve, unë nuk e di se çfarë trajtimi tjetër duhet me ju dhënë mësimdhënësve, kur ju e dini se qeveritë e mëhershme nuk e kanë bërë. Ne jemi duke e realizuar kontratën kolektive, edhe pse më shumë po kemi dëme në realizimin e projekteve të ndryshme. Mirëpo, e ka dhënë premtimin edhe kryetari dhe jemi në fund të realizimit të kontratës kolektive. Por kjo është njëkohësisht edhe përgjigje edhe për z.Baldzi, ku tha se po paguhen licencat. Pra, te kontratat kolektive paguhen shujtat, paguhen licencat, ka filluar të paguhet edhe inflacioni, mirëpo kohëve të fundit është paraparë që të paguhet edhe transporti, për ata që udhetojnë prej Prizrenit dhe qyteteve të tjera. Ju Faleminderit!

Behar Brenolli: I nderuar kryetar i komunës, i nderuar kryetar i kuvendit, të nderuar delegatë, kolegë dhe të pranishëm, Gjatë fjalimeve të disa delegatëve u bë një akuza kundër meje, se po diskriminoj Opoljen dhe punoj për Gorën. Dua të them se kjo nuk është e vërtetë. Unë jam drejtor që nga viti 2018 dhe gjithçka që kam bërë, e kam bërë njësoj për të gjithë qytetarët tanë. Këshilltarët e mëdhenj e dinë sepse kanë ndjekur çdo raport dhe nuk mjafton vetëm të lexosh sipërfaqësisht; duhet të lexosh fjalë për fjalë. Ata e dinë që në vitin 2019 u realizua renovimi i ambulancave të plota të Qendrës Shëndetësore të Familjes në komunë. Nuk po them që u renovua gjithçka. Me rreth 20,000 euro nuk mund të rinovuam gjithçka, por u krye pikturimi dhe disa rregullime sanitare. Në vitin 2023 u bë renovimi i plotë i ambulancave dhe Qendrës Shëndetësore të Familjes në Opolje. Pra, të gjitha ambulancat dhe qendrat shëndetësore në Opolje janë renovuar. Në vitet 2025 dhe 2026, për shkak të mungesës së fondeve, po rinovojmë objektet në Gorë. Kjo nuk është diskriminim ose ndonjë gjë tjetër. Dua t'ju kujtoj se buxheti i komunës së Dragashit, për shkak të përqindjes së komuniteteve pakicë, ka një shtesë, pra një përfitim krahasuar me komunat e tjera, rreth një milion euro. Kjo duhet të na bëjë krenarë, jo të jemi xhelozë. Sa i përket shtesës për fëmijë, kjo rregullohet përmes E-Kosovës, vendoset nga qeveria dhe ne nuk kemi asnjë akses ndaj saj. Sa i përket personave që na njohin, ne i njohim më mirë ata, por nuk flasim për shkak të respektit dhe përvojës që kemi. Nëse dëshirojnë të flasim, do të flasim. Pak më parë u përmendën

çështjet e apartamenteve dhe të tjera. Ai ka shumë përvojë në këtë. Po ashtu, për vendet e rezervuara – pse unë sot si drejtor i shëndetësisë nuk kam doktorë nga komunitetet pakicë, ai e di shumë mirë se sa studentë tanë mund të regjistroheshin në vendet e rezervuara dhe përse. Por, nëse dëshirohet të diskutohet, ka kohë për këtë. Faleminderit.

Granit Rifaj: Unë dola edhe një herë për ta falënderuar kryetarin për këtë projektin e rrugës Kukajan-Dragash. Këtu po shihen çka janë punimet, çka është kontrata. Të gjitha me i pa saktë unë nuk mundem, por edhe nuk jam ekspert, çka munda unë me i vlerësuese se çfarë është bërë. Por po më vjen mirë se në raport është dashur që të jetë kjo. Tash është edhe një pikëpyetje këtu: Kush e ka bërë rialokimin? Sepse në buxhet ka qenë diçka tjetër. Kush e ka bërë këtë, ajo është çështje tjetër. Këtu, siç e tha kryetari, kishte pasur edhe projekte të tjera. Sepse në raport i kemi pasur ndryshe. Stadiumin e Pllavës, trotuari në fshatin Kosovë, do me thënë rrugën e përfunduar për në Kukajan. Në qoftë se bënë edhe këto tjerat, me na i dhanë qysh na i tha kryetari. Edhe besoj se kjo nuk ishte as propagandë dhe kryetari tregoj se çfarë është punuar dhe se nuk ka keqpërdorime. Besoj që para popullit është shumë më e qartë edhe ka në anë e opozitës, po ashtu edhe ka anë e pozitës. E kam edhe një pyetje për rrugën Krushevë-Zlipotok-Brod, që është punuar. Me sa e di unë është punuar prej ministrisë, mirëpo ato punimet janë kryer në komunën tonë dhe kemi të drejtë që të bëjmë pyetje ta dimë se çfarë është punuar. Është në gjendje ta mjerueshme. Unë kam qenë vetë dhe e kam parë. Domethënë, në disa vende ka rëshqitur asfalti dhe është e dëmtuar shumë. Po ashtu, është edhe rruga magjistrale që shkon në drejtim të fshatit Restelicë. Segmenti te fshati Mlikë, d.m.th. para urës së Mlikit, është një gropë e hapur që gati po thuhet dy vite. Unë e di që nuk është përgjegjësi e Komunës, është përgjegjësi edhe e opozitës me e kërkuar atë, d.m.th. dikush duhet me e kërkuar atë pasi që është një vend potencial për me ndodhë ndonjë fatkeqësi e madhe. Ju faleminderit.

Usmen Baldzi: Drejtori i arsimit duket qartë që nuk më ka kuptuar. Unë nuk e kam akuzuar Drejtorinë se po bën ndarje apo segregim, apo se ka ndikuar në pagesën apo mospagesën e licencave në gjykatë. Këtë nuk e kam thënë. Kam thënë se është e vërtetë që kolegët që janë nën përgjegjësinë tuaj – pyesni lirshëm, thirrini – të cilët gjithashtu kanë paditur në gjykatë, nuk kanë marrë asgjë. Kjo është e vërtetë. Pyetini dhe pastaj më jepni përgjigje. Por që kam thënë se ju i ndani, këtë nuk e kam thënë. Sa i përket drejtorit të shëndetësisë, nuk e di që kur ai merret me çështjen e banesave. Kjo është çështje për drejtorin e urbanizmit. Por ata janë një ekip – dikur ishin të mitë, tani janë kundër meje. Ju më njihni shumë mirë. Nëse nuk do të më njihnit, do të ishit në

Zvicër ose në Beograd. I dashur mik Behar, banesën që e kam marrë nga programi JU nuk e kam marrë sepse jam i bukur apo sepse kam qenë në SPS. Këtë ta kam thënë në parti, por nuk ke dashur ta dëgjosh. E kam marrë sepse kam qenë kuadri më i mirë dhe edhe sot jam kuadri më i mirë në Gorë, për fat të keq. Sepse për vendet e rezervuara në arsim, ku kam qenë, nuk kam pasur kë të regjistroj, sepse nxënësit që ti i ke përgatitur nuk kanë arritur nivelin minimal të dijës për të konkurruar në mjekësi. Të mos flasim për fakultete të tjera. Pikërisht për këtë kam hapur drejtimin e mjekësisë, që nesër të ketë diçka dhe kam ndihmuar në këtë mënyrë edhe Opoljen, e cila nuk është aspak mirënjohëse. Por kjo është e kaluar. Unë e pyeta përsëri Drejtorinë e Urbanizmit, të cilën nuk e shoh këtu. Banesat në komunën e Dragashit që nuk janë blerë dhe që mund të blihen përmes vendimit të gjykatës – cilat janë ato banesa që kanë mbetur? Sepse blerja e banesave ka qenë në vitin 1992. Për ju më të rinj, po ju informoj. Pastaj, për shkak se disa nuk kanë mundur t'i blejnë – kryesisht shqiptarë – sepse pushtetet e mëparshme nuk ua lejuan, duke i larguar nga vendet e punës dhe duke mos u dhënë të drejtën e blerjes, ato banesa kanë mbetur të pa privatizuara. Tani, pas gjithë këtyre viteve, ai person përmes gjykatës realizon të drejtën e tij, sepse ka të drejtë banimi, dhe e ka blerë banesën. Ndoshta bëhet fjalë për këtë. Unë vetëm kam kërkuar të dimë kush janë këta njerëz. Është mirë ta dimë. Sepse nuk mund të lexojmë vendimet vetëm në mënyrë numerike dhe narrative. Sa për të tjerat që dini, zoti Behar, urdhëroni, këtu para kësaj kuvendi. Para këtyre njerëzve – kjo është publike. Unë jam këtu anëtar i kuvendit nga partia që ju e keni lënë, të cilës i keni kthyer shpinën dhe nga e cila keni marrë dy mandate, duke marrë kështu edhe dy drejtorë. Tani, gjithë këto gjëra pozitive për LDK-në, që ju jep krahë çdo ditë, përveç gjithë këtyre adresave email – çfarë ndodh me banesat që Qendra për Punë Sociale do t'ua ndajë qytetarëve, si shumicës ashtu edhe pakicës? Pse nuk kemi emra? A janë këta votues potencialë? Mos bëni gjithçka për zgjedhje. Keni pasur gjithçka në dorë dhe keni fituar me 150 vota. Po t'i kisha unë këto në dorë, ju nuk do të ekzistonit.

Resul Fetahu: Faleminderit! A do diksuh tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 10 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, miratohet edhe kjo pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën eventuale. Kush do me e marrë fjalën në pikën eventuale?

Usmen Baldzi: Një pyetje për drejtorin e arsimit: Pas vendimit dhe rregullores së Qeverisë së Kosovës që të gjithë ata që janë zgjedhur në zgjedhjet e vitit 2025 duhet të përcaktohen për një vend pune, në Qendrën e Shkollës së Mesme në Dragash “Ruzhdi Berisha”, dy mësimdhënës janë

larguar – më saktë, njëri ka bërë ngrirjen e vendit të punës, ndërsa unë kam kaluar në punë në Komunë. Pas kësaj, çfarë po ndodh me konkursat që duhet të hapen për vendet e lira të këtyre punëtorëve? Kam informacion nga drejtori i shkollës se një mësimdhënës i informatikës ka dalë në pension dhe orët janë ndarë mes kolegëve deri në muajin qershor, deri në përfundim të vitit shkollor, dhe pastaj do të shpallet konkursi – kështu më është thënë nga drejtoria. Nga ana tjetër, për vendin tim të punës që e kam pasur në gjimnaz, është shpallur konkurs, pastaj është anuluar, prandaj dua të di pse? Dhe nëse vendet e punës janë të lira, a mund të procedohet sa më shpejt me hapjen e tyre? Në të kundërtën, kjo mund të konsiderohet viktimizim.

Artan Loshaj: Një pyetje shumë të shkurtër, pasi që e pash një foto këtu nga z.Uzair Hamza, edhe po shkruan mbledhja e grupit punues për kthim, me sa unë e kam kuptuar. E kam një pyetje për kryetarin se nga kush është formuar ky grup dhe sa persona janë në këtë ekip? Pasi që unë e di se në komunën tonë jetojnë Goranët edhe Boshnjakët, prej minoritetit, jo vetëm votuesit e SDU-së. Po sikur mos të ishte Fitim Spahiu, çdo kush kishte menduar se janë vetëm antarët e SDU-së, dhe kishte menduar se kjo mbledhja është mbajtur në zyrat e SDU-së dhe jo në zyrat e Komunës. Ju faleminderit.

Uzair Hamza: Përshëndetje dhe respekt për të gjithë të pranishmit. Grupi punues komunal për kthim është formuar në përputhje me Rregulloren 1/2018 dhe formohet nga kryetari i komunës. Në rregullore përcaktohet qartë përbërja e këtij grupi punues. Pra, përfaqësues nga drejtoritë përkatëse, si dhe përfaqësimi gjinor dhe struktura kombëtare janë të përfshira. Nimeta Berisha është anëtare, gjithashtu nga Drejtoria e Arsimit kemi përfaqësuese Kaltrina Krasniqi. Pra, nga të gjitha drejtoritë janë marrë parasysh përfaqësuesit dhe ky grup punues është formuar. Ai formohet pas rizgjedhjes së kryetarit të ri të komunës dhe mandati i tij zgjat 4 vite. Me kërkesë të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, kjo ministri ka dërguar një shkresë në zyrën e kryetarit të komunës, kryetari e formon grupin dhe ne dërgojmë dokumentacionin përkatës për këtë grup punues. Pra, duhet të ketë përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrës, nga shëndetësia dhe mirëqenia sociale, nga arsimit dhe kështu me radhë. Pra, ashtu siç është përcaktuar në rregullore, në të njëjtën mënyrë është formuar edhe ky grup punues komunal.

Resul Fetahu: Faleminderit! A do diksuh tjetër me e marrë fjalën? Nëse nuk ka, atëherë i kisha lut mediat që t'a lirojnë sallën pasi e kemi një diskuti me dyer të mbyllura.

Të nderuar asamblesistë, kemi çështjen e vizitës studimore. Po ashtu është edhe kërkesa e juaja. Propozimi është për në Itali, tek arbëreshët e Italisë. Atëherë i hapim diskutimet.

Artan Loshaj: Jam asambleist që disa mandate. Unë e kam një propozim, se a duhet ne me e vendos një kriter. Unë e kam një propozim që ku të shkonë Kuvendi, të vijë Kryetari me dy Nënkrjetarët dhe stafi tjetër për mua është i padëshirueshëm. Unë në emër të grupit refuzoj ardhjen në vizitë studimore.

Usmen Baldzi: Sipas mendimit tim, kur grupe të caktuara shkojnë në udhëtime jashtë vendit, duhet të shkojmë diku ku mund të mësojmë diçka, që do të thotë se ai vend duhet të ketë kapacitete pothuajse të njëjta me Kosovën, Italia ka edhe Siçilinë ku janë arbreshët, kështu që unë jam për Italinë, ka një sistem perëndimor dhe mund të mësojmë diçka. Nuk mund të shkojmë në Zvicër që është superiore, çfarë do të mësojmë atje. Unë jam për Italinë. Kam një propozim që përveç delegatit, të vijnë edhe dy nënkryetarë, Arijeta që ishte kryetare e Kuvendit, tani është kryetare e kabinetit. Dhe sa i përket drejtorëve, ata kanë Bordin e tyre të Drejtorëve, nuk jam dakord që ata të jenë me ne.

Danis Hodza: Përshëndetje për gjithë! Çka tha z.Baldzi për me shkue në Itali për me mësue diçka? Nëse e kemi për me mësue diçka, shkojmë në Strasburg ose në Bruksel, aty mësohet diçka. Për Itali skemi çka me mësue. Përndryshe, ne pajtohemi aty ku pajtohet shumica. Ju faleminderit.

Resul Fetahu: Atëherë e hedhim në votim këtë propozim, për vizitën tudimore në Itali. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 14 vota për, 1 kundër dhe 0 abstenime, miratohet edhe kjo kërkesë. Atëherë e mbyllim këtë seancë! Shihemi në seancat e tjera! Faleminderit!